

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5607
E shtunë, 20 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Thaçi pranon ftesë nga shoqëria civile për ta vizituar Luginën e Preshevës | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", GJENERALLEJTËNANT
RRAHMAN RAMA | FAQE 4-5

Ushtria do të veprojë në gjithë territorin e Kosovës

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama, ka thënë se miratimi i projektligjeve për transformimin e kësaj force në ushtri është një e arritur e madhe për shtetin e Kosovës. Ai ka theksuar se kompetencat e FSK-së do të jenë të njëjta me ato të ushtrive moderne të shteteve demokratike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rama ka bërë me dije se FSK-ja do ta ketë për mision mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, por edhe obligimet e tjera që dalin varësisht prej nevojave të shtetit dhe të qytetarëve. Në këtë kontekst, ai ka deklaruar se FSK-ja do të veprojë në gjithë territorin e Republikës së Kosovë pa dalluar jugun apo verin. Gjenerallejtënant Rrahman Rama ka treguar se me mandatin e ri FSK-ja do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë



AKTUALE

DIPLOMACISË SHQIPTARE PËR BISEDIMET ME GREQINË: 'MOS MBAJ GJITHË VEZËT NË NJË SHPORTË!' | F. 11



Prof. Lisen BASHKURTI

HARADINAJ: FOKUSI YNË, LIBERALIZIMI I VIZAVE DHE ANËTARËSIMI NË INTERPOL | F. 5

MBËSHTETET IDEJA PËR THEMELIMIN E NJË GJYKATE PËR ÇËSHTJE KOMERCIALE | F. 6

EKONOMI

RRITET KONKURRUESHMËRIA DHE SIGURIA NË AEROPORTIN E PRISHTINËS | F. 8

QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHUAR | F. 8

KULTURË

GRA QË IU KANË BËRË KRAHË ECJES SONË NËPËR RRUGËT E HISTORISË | F. 13



Prof. dr. Nusret Pllana

SPORT

GJERAJ: LIRIA KËRKON PIKË NË DRENICË | F. 18

GRUPI PËR STUDIME JURIDIKE DHE POLITIKE (GLPS) KA ORGANIZUAR TRYEZËN ME TEMË "E KALUARA, E TASHMJA DHE E ARDHMJA: DIALOGU KOSOVË - SERBI"

Ish-udhëheqësit e shtetit, skeptikë për dialogun



Ish-presidenti Fatmir Sejdiu, ish-kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe ish-zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi janë deklaruar të premtën pesimistë për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në tryezën e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike ata kanë bërë me dije se në këtë fazë Kosova nuk duhet të bëjë kompromise të reja, duke shtuar se lëshimet e nevojshme Kosova i ka bërë në procesin e Vjenës | FAQE 3

Konsensusi mes partive, vendimtar për zhblokimin e jetës parlamentare



FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Palmeri: ShBA-ja përkrah transformimin e FSK-së në ushtri

BEOGRAD, 19 TETOR - Zëvendësndihmëssekretari amerikan i Shtetit, Mathew Palmer, ka thënë të premten në Serbi, se Shtetet e Bashkuara të Amerikës e mbështesin tranzicionin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në ushtri. Në një konferencë për medie me presidentin serb Aleksandar Vuçiq, zyrtari i

lartë amerikan ka thënë se tranzicionit të kësaj force dot'i nevojitet kohë. "Ne po e mbajmë këtë pozicion. Është një tranzicion që do të marrë një kohë të konsiderueshme dhe po punojmë me shumë kujdes me partnerët tanë në Prishtinë, për ta mbështetur tranzicionin, në mënyrë që të sigurohet që kjo të

bëhet në një mënyrë që do të kontribuojë në rajon dhe stabilitet", ka deklaruar Palmer. Ai tha se Shtetet e Bashkuara nuk janë duke përcaktuar ndonjë rezultat të caktuar të bisedimeve. "Ne po i inkurajojmë ta gjejnë rrugën përpara si dhe një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme të cilën do ta pranoni", tha Palmer.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës

Thaçi pranon ftesë nga shoqëria civile për ta vizituar Luginën e Preshevës

Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës e kanë ftuar presidentin Hashim Thaçi të marrë pjesë në një tryezë diskutimi dhe në promovim të një libri për Luginën e Preshevës, të cilat aktivitete kanë për qëllim promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premten ka pritur përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës. Presidenti Thaçi i ka falënderuar ata për punën që janë duke bërë për promovimin e të drejtave të shqiptarëve, në rrethana shumë të vështira. "Qytetarët e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë dhe kjo gjendje duhet të përmbyllet njëherë e përgjithmonë", u shpreh presidenti Thaçi. Kreu i shtetit ka thënë se në këtë takim kanë biseduar edhe për kërkesën e liderëve politikë dhe të shqiptarëve atje për respek-

timin e referendumit të vitit 1992 për bashkëngjitjen e Luginës së Preshevës me Republikën e Kosovës. "Si president i vendit e mbështes fuqishëm këtë të drejtë. Ndihe mirë që mbi 95 për qind të qytetarëve e mbështesin këtë ide, e cila mund të jetësohet në kuadër të korrigjimit të kufirit", ka shtuar ai.

Presidenti Thaçi ka përsëritur se me Serbinë duhet të arrihet një marrëveshje ligjërsh obliguese, e cila siguron njohjen reciproke ndërmjet dy shteteve, njohjen e pesë shteteve të BE-së, heqjen e vetos ruse në Këshillin e Sigurimit etj. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të mediave nga Lugina e Preshevës e kanë ftuar presidentin Thaçi të marrë pjesë në

një tryezë diskutimi dhe në promovim të një libri për Luginën e Preshevës, të cilat aktivitete kanë për qëllim promovimin e paqes dhe stabilitetit në rajon. "Ju falënderoj edhe për ftesën për të marrë pjesë në promovimin e librit dhe në tryezën për promovimin e paqes në rajon. Do t'i shqyrtoj të gjitha mundësitë për të marr pjesë atje, për kohën që ju keni planifikuar", ka thënë presidenti Thaçi.

Ndërsa aktivisti Sevdail Hyseni nga OJQ Perspektiva ka thënë se presidentit Thaçi ia kanë përcjellë shqetësimet e shoqërisë civile dhe të popullatës së atjeshme për vështirësitë që ballafaqohen. "I treguam se jeta kulturore në Luginë është në një stad shumë të rëndë, ndoshta është kthyer si në kohën e regjimit diktatorial. Pa zhvillim të arsimit, gjuhës dhe kulturës, nuk mund të kemi përparim shoqëror dhe kombëtar", ka

thënë Hyseni. Ai ka shtuar se në këtë takim kanë biseduar edhe për idenë e korrigjimit të kufirit, proces që do ta mundësonte bashkëngjitjen e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me Kosovën. "Ideja për korrigjimin e kufirit është e qëlluar dhe në kohën e duhur. Ne përmes pak mjeteve të informimit po mundohemi ta afirmojmë këtë ide. Kufiri i tillë duhet të korrigohet që mos të kemi telashe në të ardhmen", ka thënë ai.

Shqipëria i thotë "jo" Turqisë për ekstradimet e FETO-s

TIRANË, 19 TETOR - Ministri i Jashtëm shqiptar, Ditmir Bushati, i ktheu përgjigje homologut të vet turk Mevlut Çavusoglu, i cili kërkoi nga Shqipëria t'i largojë "terroristët turq". "Për sa i përket çështjes që ju shtroni, përgjigjja e shtetit shqiptar është ajo përgjigje që i kemi dhënë qoftë Turqisë, por edhe në planin ndërkombëtar. Shqipëria ka qenë një ndër vendet e para që është solidarizuar me çfarë ndodhi në Turqi, në rrethanat e grushtit të shtetit, por nga

ana tjetër është një vend anëtar i NATO-s, është një vend kandidat për në Bashkimin Evropian, ka aderuar në disa dokumente të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e ekstradimit dhe çdo politikë e tillë ndiqet në rrugë diplomatike dhe assesi në konferenca shtypi", tha Bushati.

Ndërsa Çavusoglu tha në konferencë se Turqia ka dorëzuar listën me emrat e FETO-s për ekstradim. "Pas tentativës për grusht të shtetit, pritshmërinë

tonë nga Shqipëria e kemi transmetuar dhe përcjellë në mënyrë të qartë në të gjitha kërkesat, hapat që duhen hedhur për eliminimin e FETO-s këtu. Eliminimin e veprimtarisë kundër Turqisë që zhvillohet këtu. Gjithmonë u kemi dhënë lista me emrat e tyre miqve tanë shqiptarë. Gjithashtu, janë edhe personat që kërkojmë ekstradimin e tyre. E kemi bërë këtë kërkesë në mënyrë zyrtare në kuadër të së drejtës ndërkombëtare. Kemi paraqitur vendimet



përkatëse të gjykatës, dokumentet përkatëse. Presim që të realizohen. Kjo është e rëndë-

sishme për ne, por edhe për Shqipërinë mike", tha Çavusoglu.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka organizuar tryezën me temë "E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja: Dialogu Kosovë - Serbi"

Ish-udhëheqësit e shtetit, skeptikë për dialogun

Ish-presidenti Fatmir Sejdiu, ish-kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe ish-zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi janë deklaruar të premtën pesimistë për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në tryezën e organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike ata kanë bërë me dije se në këtë fazë Kosova nuk duhet të bëjë kompromise të reja, duke shtuar se lëshimet e nevojshme Kosova i ka bërë në procesin e Vjenës



**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 TETOR - Ish-udhëheqësit e shtetit të Kosovës kanë shprehur skepticizëm për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në tryezën me temë "E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja: Dialogu Kosovë - Serbi", ish-presidenti Fatmir Sejdiu, ish-kryeparlamentari Jakup Krasniqi dhe ish-zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi kanë treguar rezervat e tyre për dialogun Kosovë - Serbi.

Ish-presidenti Fatmir Sejdiu ka thënë se në këtë proces nuk duhet të preket Kushtetuta e vendit. "Nuk mund të mos respektohet Kushtetuta, e më vonë të shohim se a është në rregull marrëveshja apo jo. Është problem i madh. Pa mendimin e organeve më të larta kushtetuese nuk bën të vazhdohet më tutje. Cila është esenca e asaj ideje që po korigjojmë territore? Po marrim diçka e s'po japim asgjë!", ka deklaruar Sejdiu. Ai ka përmendur vijat e kuqe të dialogut për pavarësi të Kosovës që është

zhvilluar në Vjenë. "Trepikëshi i Grupit të Kontaktit e qartëson mjaft mirë rrugën e Kosovës deri në momentin e pavarësisë së saj. Nuk ka kthim të Kosovës në vitin 1999, nuk ka bashkëngjitje të Kosovës me ndonjë shtet tjetër dhe nuk ka ndryshim të kufijve. Në Grupin e Kontaktit kanë qenë edhe ShBA-ja dhe shtetet më të fuqishme evropiane, gjithashtu edhe Federata Ruse. Secili shembull i shteteve të tjera si Bangladeshi, Sudani apo i dy Gjermanive kanë qenë kategorikisht të refuzuara në bisedime. Mendoj se asnjë iniciativë që kapërcen mandatin e paraparë me Kushtetutë nuk mund të ketë rezultat të mirë dhe çdo ekip që ka biseduar me Serbinë ka pasur mandat kushtetues", është shprehur Sejdiu.

Edhe ish-kryeparlamentari i Kosovës, Jakup Krasniqi, ka vlerësuar se Kosova në këtë proces nuk duhet të bëjë asnjë lëshim. Sipas tij, kompromiset e nevojshme Kosova i ka bërë me Pakon e Ahtisarit. "Sot ka tendenca që Kosova të japë më shumë sesa që ka dhënë në dokumentin e Ahtisarit. Nuk ka

asnjë shtet, jo vetëm të Ballkanit dhe askund tjetër që një komunitet si ai serb që ka të drejta më shumë sesa në dokumentin e Ahtisarit dhe që janë përfshirë edhe në Kushtetutën e Kosovës", është shprehur Krasniqi. Kurse ish-zëvendëskryeministri i Kosovës, Hajredin Kuçi, ka treguar se dialogu i Vjenës ka pasur një emër dhe një qëllim, ndonëse edhe atëherë, sipas tij, ka pasur dilema se a duhet të shkohet në dialog apo jo. Ai ka deklaruar se procesit të tanishëm të dialogut Kosovë - Serbi nuk ia di emrin. "Në ato kohë dialogu ka pasur emër dhe qëllim, ndërsa në vitin 2018 nuk ia di emrin. Besoj se këtu duhet të definohej si strukturë, jo vetëm politikë, por

edhe si shoqëri civile dhe të tjerët. Qëllimi i dialogut ka qenë që po shkojmë për ta fituar pavarësinë, tërësinë territoriale dhe sovranitetin. Ne duhet ta pranojmë se kahja e dialogut ka ndryshuar. Mendoj se duhet të kemi unitet për interesa të përbashkëta kombëtare dhe nuk duhet të ketë asnjë marrëveshje që e prek strukturën e shtetit të Kosovës", ka vlerësuar Kuçi.

Në këtë tryezë janë diskutuar edhe të gjeturat nga studimi i Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe për mësimet që Kosova duhet të marrë nga bisedimet e kaluara në dialogun me Serbinë. Përparim Kryeziu nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, duke prezantuar të gjeturat e studim-

it, ka përmendur shembuj të disa shteteve që kanë shpallur pavarësinë e tyre dhe rrugën deri te konsolidimi i këtyre shteteve. "Ky studim që do të publikohet gjatë javës së ardhshme, merr për bazë disa raste studimi në marrëdhënie ndërkombëtare të shteteve të cilat fillimisht kanë qenë të kontestuara dhe më pas kanë arritur të konsolidohen përfundimisht. Ka për bazë katër raste të studimit, përkatësisht Bangladeshin, Timorin Lindor, Eritrean dhe Sudanin Jugor. Këto shtete kanë shpallur pavarësinë e tyre në vitet gjegjëse, mirëpo ato fillimisht kanë qenë të kontestuara përderisa nuk kanë marrë aprovimin e shteteve pararendëse", ka thënë Kryeziu.

Vasfije Krasniqi-Goodmanit i njihet statusi i viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të premtën në takim Vasfije Krasniqi-Goodman, viktimë e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe drejtoreshën e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, Feride Rushiti. Ministri Reçica ka përgëzuar Krasniqi-Goodman për kurajën dhe vullnetin për ta rrëfyer ngjarjen e saj, duke u bërë zëri që theu heshtjen që na përcolli për shumë vjet. "Zëri yt është zëri i të gjitha atyre motrave dhe nënave tona që ndër shekuj kanë heshtur me gjëmën e tyre", ka deklaruar ministri. Ministri Reçica ka thënë se në

kuadër të përpjekjeve institucionale, Qeveria ka themeluar komisionin për njohjen dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës. "Kjo është e pakta çfarë mund të bëjmë dhe jemi të vetëdijshëm që nuk është e mjaftueshme. Nevojitet guximi ynë qytetar dhe moral që të mos heshtim, që ta ngrehim zërin, që ta themi të vërtetën me zë", është shprehur ministri Reçica. Gjatë takimit në mënyrë simbolike ministri Reçica dhe kryetarja e komisionit qeveritar për verifikim dhe njohjen e statusit të të dhunuarve gjatë luftës në Kosovë, Minire Begaj, i dhanë Krasniqi-Goodman vendimin për njohjen e statusit.

Flet për "Epokën e re", gjeneralletenant Rrahman Rama

Ushtria do të veprojë në gj

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, ka thënë se miratimi i projektligjeve për transformimin e kësaj force në ushtri është një e arritur e madhe për shtetin e Kosovës. Ai ka theksuar se kompetencat e FSK-së do të jenë të njëjta me ato të ushtrive moderne të shteteve demokratike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Rama ka bërë me dije se FSK-ja do ta ketë për mision mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, por edhe obligimet e tjera që dalin varësisht prej nevojave të shtetit dhe qytetarëve. Në këtë kontekst, ai ka deklaruar se FSK-ja do të veprojë në gjithë territorin e Republikës së Kosovë pa dalluar jugun apo veriun. Gjeneralletenant Rrahman Rama ka treguar se me mandatin e ri FSK-ja do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralletenant Rrahman Rama, e ka vlerësuar arritur të madhe shtetërore aprovimin e tri projektligjeve që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në ushtri. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka bërë me dije se kompetencat e FSK-së do të jenë të njëjta me ato të ushtrive moderne të shteteve demokratike. "Aprovimi i këtyre tri projektligjeve në leximin e parë është një e arritur e madhe për Kosovën dhe për Forcën e

Sigurisë së Kosovës. I falënderoj të gjitha partitë politike që i kanë dhënë përkrahje FSK-së. Kjo dëshmon edhe respektin e besueshmërinë që na kanë dhënë qytetarët. Kjo është meritë e të gjithëve dhe falënderoj secilin për angazhimin. Natyrisht se tani na pret një punë e madhe dhe jam i sigurt se me këta pjesëtarë dhe zhvillimin e tyre profesional do t'i realizojmë planet tona", është shprehur ai.

Rama ka deklaruar se FSK-ja do ta ketë për mision mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, por edhe obligimet e tjera që dalin varësisht prej nevojave të shtetit dhe qytetarëve. "Kompetencat e Forcës

së Sigurisë së Kosovës do të jenë të njëjta me ato të ushtrive moderne të shteteve demokratike. FSK-ja do ta ketë për mision mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, por edhe obligimet e tjera që dalin varësisht prej nevojave që i kanë autoritetet civile. Ne jemi nën kontrollin civil demokratik dhe të gjitha obligimet, detyrat dhe nevojat që dalin prej institucioneve dhe qytetarëve, do ta kenë përkrahjen e FSK-së", ka theksuar ai, duke shtuar se FSK-ja do të veprojë në gjithë territorin e Republikës së Kosovë pa dalluar jugun apo veriun. "Në projektligjet që janë aprovuar në Kuvend nuk shkruan në jug apo

në veri, por në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ju i keni ligjet dhe mund t'i shikoni. Ligji duhet të respektohet nga të gjithë. Në detyrën ku jam mua ligji më obligon ta zbatoj sikurse që i obligon të gjitha institucionet. Unë thashë se FSK-ja do të ketë përgjegjësi për mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Edhe dihen kufijtë e Kosovës ku janë", ka thënë Rama.

Ai ka treguar se me mandatin e ri FSK-ja do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë.

"Epoka e re": Z. Rama, Kuvendi i Republikës së Kosovës të enjten me 101 vota ka miratuar

në lexim të parë tri projektligje përmes të cilëve parashihet transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovë ushtri. Si e pritët këtë vendim?

Rama: Aprovimi i këtyre tri projektligjeve në leximin e parë është një e arritur e madhe për Kosovën dhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ky është vetëm hapi i parë dhe tani presim edhe leximin e dytë, pastaj hyrjen në fuqi të këtyre ligjeve. I falënderoj të gjitha partitë politike që i kanë dhënë përkrahje FSK-së dhe kjo dëshmon edhe respektin e besueshmërinë që na kanë dhënë qytetarët. Kjo është meritë e të gjithëve dhe falënderoj secilin për angazhimin. Natyrisht se tani

ithë territorin e Kosovës

na pret një punë e madhe dhe jam i sigurt se me këta pjesëtarë dhe zhvillimin e tyre profesional do t'i realizojmë planet tona.

"Epoka e re": *Cilat janë vështirësitë e procesit të transformimit të FSK-së dhe sa do të jetë kohëzgjatja e tij?*

Rama: Në njëfarë forme tash fillon puna në kuptimin profesional dhe operacional. Kemi një plan afatgjatë të cilin e kemi planifikuar së bashku me partnerët tanë. Ky plan është dhjetëvjeçar. Edhe me kohën dhe me planin jemi fleksibil dhe varësisht prej situatës dhe rrethanave që do të krijohen në të ardhmen, ashtu edhe do të veprojmë.

"Epoka e re": *Cili do të jetë misioni dhe kompetencat e FSK-së tash e tutje?*

Rama: Kompetencat e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të jenë të njëjta me ato të ushtrive moderne të shteteve demokratike. FSK-ja do ta ketë për mision mbrojtjen e integritetit territorial të Kosovës, edhe obligimet e tjera që dalin varësisht prej nevojave që i kanë autoritetet civile. Ne jemi nën kontrollin civil demokratik dhe të gjitha obligimet, detyrat dhe nevojat që dalin prej institucioneve dhe qytetarëve, do ta kenë përkrahjen e FSK-së.

"Epoka e re": *FSK-ja do të ketë mision ushtarak, por emri do të mbetet i njëjtë?*

Rama: Emri është çështje politike sepse pa ndryshime kushtetuese është e pamundur të ndryshohet. Mirëpo, nuk është me rëndësi emri sa është i rëndësishëm mandati dhe misioni që do ta ketë FSK-ja në të ardhmen. Emri do të jetë opsion i hapur sepse procesi

do të vazhdojë dhe kurdo që të krijohen kushtet politike mund të ndryshohet. Çështja e emrit kërkon konsensus, por besoj se në të ardhmen do të ndryshohet edhe emri.

"Epoka e re": *FSK-ja do të ketë mandat të veprojë edhe në veri të vendit?*

Rama: Në projektligjet që janë aprovuar në Kuvend nuk shkruan në jug apo në veri, por në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

"Epoka e re": *Përfshirë edhe veriun, i cili që nga lufta e fundit nuk kontrollohet nga shteti i Kosovës?*

Rama: Ju i keni ligjet dhe mund t'i shikoni. Ligji duhet të respektohet nga të gjithë. Në detyrën ku jam, ligji më obligon ta zbatoj sikurse që i obligon të gjitha institucionet.

"Epoka e re": *Për hir të korrektesisë, FSK-ja do të veprojë në gjithë territorin e Republikës së Kosovës?*

Rama: Unë thashë se FSK-ja do të ketë përgjegjësi për mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Dihet kufijtë e Kosovës ku janë.

"Epoka e re": *Gjeneral, prisni reagime nga ndërkombëtarët për këtë proces, meqë ata kanë insistuar që transformimi i FSK-së të bëhet sipas ndryshimeve kushtetuese?*

Rama: Çfarë reaguesh?

"Epoka e re": *Reagime përmes të cilave mund të kundërshtohet ecuria e këtij procesi?*

Rama: Unë, zëvendësi dhe të tjerët kemi qenë në shumë vende të ndryshme dhe në kryeqytetet kryesore të Evropës, edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shteti normal dhe i pavarur duhet t'i

ketë edhe shtyllat e veta. Një prej tyre është ushtria e Kosovës. Qëllimi kryesor i të gjithë neve ka qenë që transformimi të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese, mirëpo dihen botërisht arsyet pse nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Prandaj nuk ka ndonjë kundërshtim. Kemi qenë transparentë gjatë gjithë kohës dhe do të vazhdojmë të jemi transparentë. Gjithçka çfarë kemi bërë deri tash është bërë duke u bazuar në standardet e NATO-s dhe së bashku me NATO-n.

"Epoka e re": *Kjo iniciativë është bërë në koordinim të plotë me aleatët?*

Rama: Në vitin 2009 kur është bërë transformimi i TMK-së në FSK përgjegjëse kryesore për ndërtimin e një institucioni të ri ka qenë NATO-ja. Të gjithë kemi kaluar në një proces të përzgjedhjes. Sot jemi pjesë e FSK-së. Autoriteti kryesor i bërjes së kësaj organizate ka qenë NATO.

"Epoka e re": *Këto ditë keni pasur disa vizita jashtë shtetit. E keni marrë mbështetjen e zyrtarëve të huaj për këtë çështje?*

Rama: Po, patjetër. Kemi qenë edhe në ShBA. Kemi pasur takime të rëndësishme, ku edhe kemi marrë përkrahjen e plotë për zgjerimin e kompetencave të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Kemi punuar në koordinim me Presidencën, Kuvendin, Qeverinë, Komisionin për Mbikëqyrje të FSK-së si dhe kemi qenë në koordinim të plotë me partnerët tanë.

"Epoka e re": *Pas vendimit për themelimin e ushtrisë, ka pasur reagime nga Serbia. Cili është koment juaj lidhur me*

pretendimet e zyrtarëve serbë me këto veprime?

Rama: Nuk dëshiroj t'i komentoj reagimet e të tjerëve sepse kjo është çështje e brendshme e Kosovës dhe ne do ta vazhdojmë punën tonë. Po ndërtojmë një forcë që është në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallime. FSK-ja ka dëshmuar se nuk është shpenzuese e sigurisë, por konsumuese e sigurisë. Në bazë të takimeve dhe konferencave të ndryshme që kam marrë pjesë, është vlerësuar se FSK-ja është për të mirën e vendit, në të njëjtën kohë edhe për të mirën e rajonit.

"Epoka e re": *Sa do të jetë numri i pjesëtarëve të FSK-së dhe me çfarë armatimi do të pajisen?*

Rama: FSK-ja do të jetë forcë ushtarake shumetnike dhe e armatosur. Forca e Sigurisë së Kosovës do t'i ketë 5 000 pjesëtarë aktivë dhe 3 000 rezervë. Pra, do të ketë rritje qind për qind. Dhe rekrutimi i parë do të jetë në fillim të vitit të ardhshëm. Varësisht prej zhvillimeve do të ketë rritje të forcës.

"Epoka e re": *Nëse vazhdohet me këtë ritëm dhe sipas planit që keni paraparë, kur besoni se FSK-ja mund të bëhet pjesë e NATO-s?*

Rama: NATO-ja sa është organizatë ushtarake është edhe politike. Nuk shoh ndonjë problem sa i përket anëtarësimit të FSK-së në NATO. Ky është qëllimi ynë kryesor. Mirëpo duhet ta kuptojmë se ky është edhe proces politik dhe nuk varet vetëm prej nesh. Synimi ynë kryesor është që të jemi pjesë e strukturave euroatlantike. FSK-ja do ta vazhdojë zhvillimin dhe punën në shërbim të qytetarëve dhe të vendit.

Haradinaj: Fokusi ynë, liberalizimi i vizave dhe anëtarësimi në Interpol

PRISHTINË, 19 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të premten një takim pune në Ministrinë e Punëve të Brendshme, për ta parë nga afër punën që po e zhvillon ky institucion i vendit, me rastin edhe të marrjes së detyrës të ministrit të ri të Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa.

Në konferencën për media pas takimit, kryeministri Haradinaj ka thënë se ky ishte një takim pune dhe se fokusi ishte te tri temat bazë e që, siç theksoi ai,

është vetë luftimi i krimit dhe ruajtja e rendit publik në vend, por edhe dy punët e tjera si Interpoli dhe liberalizimi i vizave. "Kam ardhur të bisedojmë, të qartësohemi, se a e kemi mbuluar çdo vakum potencial dhe a ekziston një koordinim i mirëfilltë i ndërsjellë nga niveli politik në këtë rast ministri dhe të gjithë të ngarkuarit në punë", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ai ka shtruar se përshtypja që pati nga takimi i sotëm është se të gjithë janë në nivel të punës,

edhe ministri që i ka marrë përgjegjësitë, por edhe zyrtarët e tjerë, duke shprehur kështu falënderime për punën e tyre, në veçanti policinë e Kosovës që, siç ka thënë ai, punojnë për ofrimin e sigurisë së vendit për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, pasi e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për vizitën, ka thënë se ky takim është zhvilluar për nevojat dhe detyrat që i ka kjo ministri.



Malta është vend mik i Kosovës

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - "Malta është një nga vendet mike të Kosovës dhe ne kemi zhvilluar gjithmonë raporte korrekte me këtë vend. Ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe Kosova është e përkushtuar t'i avancojë raportet e ndërsjella në të gjitha fushat", ka thënë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, pasi ka pritur të premten në takim ambasadorin e Maltës, jorzident në Kosovë, Godwin Pulis.

Kryeministri Haradinaj e njoftoi ambasadorin Pulis me progresin e arritur në Kosovë dhe prioritetet e Qeverisë për zhvillim ekonomik, integrimet evropiane, si dhe fuqizimin në rend dhe ligj. Duke e falënderuar për kontributin e Maltës dhënë për shtetndërtimin e Kosovës në të gjitha fazat e saj, kryeministri

Haradinaj shprehu përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e bashkëpunimit bilateral me këtë shtet mik edhe më tutje, duke u fokusuar më shumë në bashkëpunim në fushën e arsimit dhe në fuqizimin e partneritetit ekonomik në mes të dy vendeve.

Kryeministri Haradinaj kërkoi nga Ambasadori Pulis mbështetjen e vendit të tij në anëtarësimin e Kosovës në mekanizmat ndërkombëtarë dhe në fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të vendit.

Ambasadori Godwin Pulis, shprehu përkrahjen e Maltës për Kosovën si dhe përkushtimin për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit. Pjesë e këtij takimi ishte edhe zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.



Mbështetet ideja për themelimin e një gjykate për çështje komerciale

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Ministria e Drejtësisë dhe Oda Ekonomike e Kosovës të premten kanë organizuar tryezë diskutimi në kuadër të kampanjës "Drejtësia dhe biznesi", e nisur nga ministri Abelard Tahiri. Kjo tryezë përfshiu përfaqësues nga bizneset e sektorëve të ndryshëm, përfaqësues të Fakultetit Juridik, odave dhe asociacioneve dhe shoqatave të ndryshme të biznesit, Odës së Avokatëve, përfaqësuesve të Departamentit Ekonomik pranë Gjykatës së Apelit dhe ekspertë të kësaj fushe. Ky diskutim u organizua me qëllim të promovimit të reformave që kanë filluar në kuadër të procesit të rishikimit funksional të sektorit të sundimit të Ligjit në fushën e drejtësisë komerciale. Gjatë këtij diskutimi ministri i



Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka potencuar ecurinë e deritanishme të procesit të rishikimit funksional në sektorin e drejtësisë komerciale dhe ka thënë se rezultatet e analizave të deritanishme gjithëpërfshirëse tregojnë se

Kosova përballlet me mungesë të efikasitetit të sistemit gjyqësor, me fokus në këtë fushë. Ai ka theksuar se është i vendosur që këtë gjendje ta ndryshojë duke mbështetur idenë e themelimit të një gjykate të veçantë për traj-

timin e çështjeve me karakter komercial.

Kapacitetet e tanishme të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit nuk janë të mjaftueshme, ishte konstatim ky i cili fuqishëm u mbështet edhe nga përfaqësuesit e gjyqësorit dhe të bizneseve, por edhe aktorët e tjerë të pranishëm.

Ministri Tahiri ka thënë se është shumë i interesuar që çfarëdo reforme e cila vendoset të bëhet të jetë rezultat i një diskutimi të gjerë në mënyrë që implementimi i saj të jetë i lehtë si rezultat i nevojës reale dhe gjithëpërfshirëse.

Rendësi e veçantë iu dha përbërjes dhe ndërtimit të një gjykate e cila do t'i ketë të gjitha kapacitetet e nevojshme për t'u përballur me kontestet eventuale të bizneseve

në një ambient bashkëkohor të ekonomisë së tregut të lirë. Andaj u theksua se duhet të fillohet sa më parë të ngrehen kapacitetet e nevojshme të cilat i nevojiten një gjykate të tillë.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka folur për rëndësinë e madhe që ka një sistem efikas dhe transparent i drejtësisë për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai ka potencuar se Oda Ekonomike është duke kaluar reforma strukturore ku planifikohet edhe themelimi i një mekanizmi për mbrojtjen e interesave të bizneseve. Rukiqi ka mbështetur fuqishëm idenë e themelimit të një gjykate për çështje komerciale, duke thënë se Oda Ekonomike është në dispozicion të plotë për promovimin dhe avancimin e kësaj reforme.

Kërkohet vlerësim i punës së fizioterapeutëve

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 TETOR - Të premten është mbajtur Kongresi i Parë Ndërkombëtar i Fizioterapisë në Kosovë. I pranishëm në këtë kongres ishte edhe kryeministri Ramush Haradinaj, me ç'rast ka uruar suksese në punimet e kongresit. Ai ka thënë se përmbyllja e fazës së shërimit, në shumë raste, e kërkon jo vetëm pjesën tuaj, por edhe një kulturë për atë se çfarë nënkupton pjesa juaj e punës. Haradinaj ka thënë se, pavarësisht se është rritur buxheti për shëndetësinë, është hartuar projektligji për pagat, i cili ka trajtuar me një respekt të posaçëm mjekët dhe personelin mjekësor, prapëseprapë ka shumë punë për t'u bërë për një vetëdijësim të të gjithëve. "Në emër të Qeverisë së vendit, duke ju uruar punime

të suksesshme në këtë kongres ndërkombëtar, ju ftoj të rrugëtojmë bashkë për të mirën e pacientit dhe shëndetësisë në Kosovë", ka thënë kryeministri Haradinaj. Ndërkaq Bekim Haxhiu, kryetari i Kongresit, ka thënë se kanë punë për të bërë dhe se në bashkëpunim me Qeverinë dhe mbështetësit e tjerë do ta ngrehen edhe më lartë fizioterapinë në Kosovë. "Puna e fizioterapeutëve duhet të vlerësohet në vendin tonë. Ata duhet të jenë krenarë me punën e tyre. Ne ishim të parët në rajon që në Fakultetin e Mjekësisë filluam me programin e fizioterapisë. Ne për këtë fakt duhet edhe t'i ruajmë fizioterapeutët që janë në Kosovë", ka thënë Bekim Haxhiu.

Ky kongres është organizuar nën përkujdesjen e kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.



Përfaqësues të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) kanë mbajtur konferencë për media lidhur me funksionimin e punës së Kuvendit të Kosovës

Konsensusi në mes të partive, vendimtar për zhbllokimin e jetës parlamentare



Artan Murati nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka theksuar se më shumë se një vit nga konstituimi i legjislaturës së gjashtë, Kuvendi nuk ka arritur të funksionojë në mënyrë adekuate dhe vazhdimisht është përballur me kriza të ndryshme, kryesisht të natyrës politike. Gjithashtu, sipas tij, edhe me fillimin e sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit është shtuar bllokada e punës në këtë institucion

mbajë takime të rregullta dhe të thërrasë seanca në intervale më të shpeshta kohore, duke mos lejuar grumbullimin e shumë pikave të rendit të ditës, pasi që kjo është duke ndikuar në mospërbushjen e agjendës legjislative.

Sa i përket rolit të opozitës, ai ka nënvizuar se deri më tani grupet parlamentare opozitare nuk kanë pasur një strategji të përbashkët qoftë për bojkotim të punës së Kuvendit apo për zgjedhje të reja. "Kjo qasje e pakoordinuar ka qenë joproductive dhe nuk ka arritur t'i sjellë rezultatet e pritshme për opozitën. Ndonëse subjektet opozitare nuk e kanë obligim t'ua bëjnë numrat subjekteve në pushtet, megjithatë konstruktiviteti për të mirën e përgjithshme është i nevojshëm", është shprehur Murati. Ai ka thënë se konsensusi në mes të subjekteve politike është vendimtar në këtë periudhë, dhe se debati assesi nuk duhet të zhvendoset në forume të tjera jashtë Kuvendit të Kosovës.

Ndërsa Jeta Krasniqi nga KDI-ja ka folur lidhur me dialogun Kosovë - Serbi si një ndër çështjet që po ndikon në bllokimin e punës së Kuvendit dhe bojkotimin e punimeve të seancave plenare nga ana e opozitës. Ajo ka vlerësuar se

fillimi i fazës së re të dialogut Kosovë - Serbi ka shkaktuar polarizim mes partive politike në Kosovë rreth pritshmërive nga ky proces, temave që duhet të diskutohen dhe kush duhet ta udhëheqë procesin e dialogut. "Mungesa e konsensusit për këtë çështje ka ndikuar edhe në mbarëvajtjen e punës së Kuvendit. Shumica parlamentare nuk ka arritur ta sigurojë numrin e deputetëve për t'i shtyrë përpara iniciativat e saj, ndërsa ka bojkotuar seancën e thirrur nga opozita. Bojkoti i dyanshëm i seancave rezultoi që asnjëra nga iniciativat të mos votohen. Seanca e thirrur nga opozita ka mbetur ende e patrajtuar, për të cilën opozita kishte deklaruar se nuk do të marrin pjesë në seanca të rregullta pa u kryer seanca e thirrur nga opozita", ka thënë ajo.

Duke konsideruar rëndësinë e kësaj teme shtetërore, Krasniqi ka potencuar se KDI-ja vlerëson se debati rreth dialogut Kosovë - Serbi duhet të zhvillohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku duhet të përpilohet platforma shtetërore rreth këtij procesi. Sipas tij, Kuvendi duhet të jetë proaktiv dhe në këtë proces duhet t'i përcaktojë edhe vijat e kuqe të dialogut si institucioni më i lartë vendimmarrës që nuk duhet të anashkalohej. "Partitë politike duhet të arrijnë

konsensus politik mbi procesin e dialogut para arritjes së një marrëveshjeje eventuale me Serbinë për t'i evituar skenarët e së kaluarës si atë të marrëveshjes me Malin e Zi e cila, në mungesë të një konsensusi politik, dëmtoi shtetin e Kosovës si në sferën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme", është shprehur Krasniqi.

Në të njëjtën kohë, ai ka thënë se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të kërkojë sqarim nga Qeveria e Kosovës se çfarë është duke ndodhur me procesin e dialogut teknik, kush e udhëheq këtë proces, duke konsideruar se shefi i negociatave, i emëruar nga kryeministri, është duke pritur emërimin për ambasador në Emirate të Bashkuara Arabe (EBA). Krasniqi ka vlerësuar se Kuvendi duhet të kërkojë që Qeveria e Kosovës t'i dorëzojë të gjitha dokumentet lidhur me marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut përgjatë shtatë vjetëve si dhe të kërkojë në mënyrë urgjente raportim nga ana e kryeministrit të Kosovës rreth marrëveshjeve të arritura deri më tani, cilat janë marrëveshjet, sa janë zbatuar këto marrëveshje, çfarë efekte kanë sjellë, ku janë ngecjet e procesit dhe cilat janë propozimet e Qeverisë lidhur me statusin e këtyre marrëveshjeve.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 TETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të premtën konferencë për media lidhur me funksionimin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, Artan Murati nga KDI-ja ka theksuar se më shumë se një vit nga konstituimi i legjislaturës së gjashtë, Kuvendi nuk ka arritur të funksionojë në mënyrë adekuate dhe vazhdimisht është përballur me kriza të ndryshme, kryesisht të natyrës politike. "Me fillimin e sesionit vjeshtor të punës së Kuvendit është shtuar edhe bllokada e punës në Kuvend, duke paralizuar kështu jetën parlamentare. Nga të gjitha seancat e mbajtura këtë sesion, vetëm një ka arritur të përfundojë në ditën kur ka filluar. Ndonëse shpeshherë mosfunksionimi i punës në

Kuvend është duke iu atribuar bojkotit opozitar të punës së Kuvendit, megjithatë faktorët e mosfunksionimit të Kuvendit janë të shumëllojta", ka thënë ai.

Mungesat e deputetëve nga shumica parlamentare është një nga problemet kryesore të kësaj legjislature, trend ky i cili është duke vazhduar edhe në sesionin vjeshtor. KDI-ja konsideron se grupet parlamentare në mazhorancë duhet të jenë mirë të koordinuara për ta mundësuar zhvillimin e seancave plenare. "Nëse subjektet opozitare janë duke ushtruar të drejtën e tyre për bojkotim të Kuvendit, koalicioni qeverisës duhet të mobilizohet për t'i siguruar numrat e mjaftueshëm për mbarëvajtjen e seancave plenare dhe komisioneve parlamentare", ka shtuar ai.

Murati ka potencuar se KDI-ja fton Kryesinë e Kuvendit të

Kosova dhe Greqia pritet ta thellojnë bashkëpunimin në fushën e financave



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të premten në takim përfaqësuesen e Zyrës së Greqisë në Prishtinë, Chrissyoula Aliferi, me të cilën ka diskutuar në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve, sidomos

në fushën e financave. Me këtë rast, ministri Hamza ka shprehur gatishmërinë e tij si ministër i Financave për vazhdimin dhe thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërinstitucional. Në këtë takim ministri Hamza e

ka njoftuar përfaqësuesen Chrissyoula Aliferi për zhvillimet e fundit në Ministrinë e Financave, me theks të veçantë për përgatitjen e buxhetit të shtetit për vitin 2019, si dhe për takimet me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ai e ka

njoftuar përfaqësuesen Aliferi për reformat fiskale që ka ndërmarrë dhe do të marrë Qeveria e Kosovës, të cilat mundësojnë dhe ndikojnë në krijimin e kushteve më të mira në të bërit biznes. Ndërsa përfaqësuesja greke

Chrissyoula Aliferi e ka falënderuar ministrin Bedri Hamza për bashkëpunimin dhe ka shprehur gatishmërinë e saj dhe të shtetit grek për vazhdimin e këtij bashkëpunimi ndërinstitucional, sidomos në aspektin ekonomik dhe financiar.

Qendra e Trajnimit të KEK-ut, mundësi për aftësim profesional

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Qendra e Trajnimit të KEK-ut është hapur në vitin 2005. Gjatë këtyre viteve në këtë Qendër janë aftësuar dhe trajnuar punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës, mirëpo me ngritjen e kapaciteteve tani ofron trajnime edhe për të gjithë të interesuarit jashtë KEK-ut. "Qendra e trajnimeve ofron shumëllojshmëri të trajnimeve por janë jashtëzakonisht të kërkuara: aftësimi për makineri të rënda, elektrike, saldimit, mekanike dhe pneumatike. Qendra e Trajnimit të KEK-ut për këto drejtime ka laboratorë profesionalë të cilët janë të vetmit në rajon. Kjo qendër ka trajnerë të

certifikuar dhe licencuar sipas standardeve më të larta ndërkombëtare. Si rrjedhojë, përveç certifikatave që i lëshon qendra, me kërkesë të kandidatëve ata mund të pajisen edhe me certifikata të njohura ndërkombëtare", ka theksuar zëdhënësi i KEK-ut, Skënder Bucolli.

Kjo qendër ka disa laboratorë të fushave të ndryshme të cilat janë të kompletuar me pajisje adekuate, për ta bërë të mundur implementimin sa më të suksesshëm të trajnimeve. Në Kosovë ka shumë fabrika të vogla që merren me hidraulikë dhe pneumatikë mirëpo, fatkeqësisht, nuk ka mjaftueshëm njerëz që merren me

këta lëmenj. Prandaj, kjo qendër është mundësi e mirë për ngritjen profesionale bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe ndërkombëtare për të punuar me hidraulikë dhe pneumatikë", ka thënë Elmi Konjusha, ekspert i lartë për trajnime teknike.

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi u shprehën se janë shumë të kënaqur nga aftësimi që kanë marrë nga ky trajnim dhe tani ndihen të sigurt në vendin e tyre të punës. Përfaqësuesit e KEK-ut u bëjnë thirrje të gjithë të interesuarve që t'i drejtohen kësaj qendre për një aftësim dhe kualifikim me standardet më të larta ndërkombëtare.



Rritet konkurrueshmëria dhe siguria në Aeroportin e Prishtinës



PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka realizuar të premten një vizitë inspektuese në punimet e zgjatjes së pistës së Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari". Me këtë rast, kryeshefi ekzekutiv i ANP "Adem Jashari", Haldun Firat Kokturk, e ka informuar në mënyrë të detajuar ministrin Lekaj për punimet që janë duke u realizuar në këtë projekt.

Pista e ANP "Adem Jashari" do të zgjatet nga 2 500 metra sa është momentalisht, në 3 000 metra

dhe pritet të përfundojë dimrin e vitit të ardhshëm.

Vlera e projektit për zgjatjen e pistës është rreth 34 milionë euro. Këtë vit janë ndarë 2.1 milionë euro, për vitin 2019 do të ndahen 10 milionë euro, kurse për vitin 2020 rreth 21 milionë euro.

Ministri Lekaj, duke iu adresuar medieve, ka thënë se punimet janë duke u realizuar me intensitet të lartë dhe pret që ato të përfundojnë me kohë. Ai ka shprehur bindjen se që nga viti i ardhshëm Aeroporti "Adem

Jashari" do të jetë më atraktiv, më i sigurt dhe do të konkurrojë me aeroportet më të zhvilluara të Evropës.

Zgjatja e pistës së ANP "Adem Jashari" do ta risë nivelin e sigurisë kombëtare, duke ia mundësuar çdo fluturakeje të aterojë në rast të fatkeqësive, konflikteve të armatosura apo fatkeqësive natyrore. Njëkohësisht, ky investim do t'i evitojë humbjet financiare si dhe plotësojë kriteret e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) si dhe të Agjencisë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit.

Qeveria miraton Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 TETOR - Qeveria e Kosovës ka marrë të premten një nga vendimet më të rëndësishme për ekonominë e vendit, duke miratuar Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar. Projektligji adreson rregullimin e sistemit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) në territorin e Republikës së Kosovës, sistem i cili përfshinë aplikimin e tatim-

it të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime. Projektligji vlerësohet si pjesa më e rëndësishme e reformës fiskale të Qeverisë dhe ofron lehtësi dhe lirime që do ta ndihmojnë zhvillimin e biznesit në vend.

TVSh-ka është e përshkallëzuar në dy norma, atë standarde prej 18 përqindësh dhe normën e reduktuar prej 8 përqindësh, të vlerës së furnizimeve të importuara dhe furnizimeve të

brendshme të tatueshme, me përjashtim të furnizimeve të liruara dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte. TVSh-ja llogaritet në çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në mallra dhe shërbime, e që bartet nga konsumatori i fundit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimin për kursimin, ndarjen dhe transferime buxhetore të organizatave, në pajtim me nenin

15 të Ligjit për Buxhetin e vitit 2018. Me këtë vendim operacionalizohen shpenzimet buxhetore për vitin 2018 duke bërë të mundshëm realizimin dhe implementimin e politikave qeveritare gjatë këtij viti.

Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për miratimin e nisjes të Ministrisë së Financave për negociimin e marrëveshjes ndërkombëtare të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për

Zhvillim për financimin e "Projektit për patundshmëri dhe infrastrukturë gjeohapësimore".

Marrëveshja siguron një kredi të favorshme në vlerë 16,5 milionë dollarë dhe do të shërbejë në implementimin e këtij projekti. Po ashtu, Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten edhe kërkesën për ndarjen e 1.2 milion eurove për trupin koordinues të lobimit për anëtarësimin e Kosovës në Interpol.

Bizneset t'i rrisin masat për mbrojtjen kibernetike



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 19 TETOR - Zhvillimet e shpejta në ekonominë digjitale në nivel global e me shtrirje edhe në Kosovë janë një kërcënim i vazhdueshëm për sigurinë e qytetarëve dhe të bizneseve, prandaj duhen ndërmarrë masa edhe nga institucionet dhe qytetarët për ta rritur efektivitetin e sistemeve të mbrojtjes nga sulmet kibernetike. Kështu u tha të premten në një tryezë të organizuar nga Oda Ekonomike

Amerikane në Kosovë në kuadër të shënimit të Muajit të Sigurisë Kibernetike.

Në hapje të tryezës, drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se në përgjithësi në Kosovë është rritur vetëdija për sa i përket përfitimeve të vendit nga ekonomia digjitale por, pavarësisht kësaj, pak flitet për rreziqet kibernetike. Ai përmendi disa organizata të cilat janë aktive në këtë aspekt siç është rasti me Qendrën e Inovacionit të Kosovës, derisa shtoi se duke e ditur se bizneset

përbëjnë një rrezik potencial të sulmeve kibernetike, edhe Oda Amerikane është aktive në këtë aspekt.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra, ka thënë se Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria e Kosovës janë të vetëdijshme për trendet rritës të sulmeve kibernetike dhe si rrjedhim mbesin mjaft aktive për t'i ndërmarrë masat e nevojshme për t'u përgjigjur kërcënimeve të mundshme.

Udhëheqësi i Sektorit për

Hetimin e Krimeve Kibernetike nga Policia e Kosovës, Fadil Abdyli, ka theksuar se Policia e Kosovës, pavarësisht se ka në fokus hetimin e krimeve, ka qenë e kujdesshme t'i informojë bizneset edhe për rreziqet e mundshme me të cilat ata përballen, duke shpërndarë udhëzime për sa i përket masave që duhen ndërmarrë për shmangien e rreziqeve kibernetike. Ai tha se këtë vit është vënë re një rritje e kërcënimeve për bizneset, prandaj këtyre të fundit u bëhet thirrje ta rrisin sigurinë e sistemeve të

teknologjisë informative. Agim Bekaj, përfaqësues i kompanisë "Microsoft", foli për rëndësinë që janë sistemet e licencuara kompjuterike dhe rreziqet që paraqiten nga softuerët piraterikë. Ndërsa Drinor Selmanaj, themelues i Kompanisë "Sentry", si dhe ligjërues aktiv në fushën e mbrojtjes kibernetike, foli për format aktuale të kërcënimeve kibernetike dhe për masat e kujdesit që bizneset dhe punonjësit e tyre duhet të ndërmarrin në kuadër të mbrojtjes më aktive kibernetike.

Mbahet diskutimi publik për draftstatutin e teatrit 'Adriana'

FERIZAJ, 19 TETOR (ER) - Në ambientet e Kuvendit të Komunës së Ferizajt të premtën është mbajtur diskutimi publik për draftstatutin e teatrit profesionist "Adriana Abdullahu". Takimin e



hapi kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Kristina Gashi Bytyçi, ku pjesëmarrës ishin edhe drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhemile Murati-Shabani si dhe Albion Sherifi, anëtar i Këshillit Drejtues të Teatrit "Adriana Abdullahu", aktorë të ansamblit rezident të aktorëve të teatrit "Adriana" si dhe mediet dhe shoqëria civile.

Kryesuesja e Kuvendit të komunës, Kristina Gashi Bytyçi, ka thënë se ky dokument ka marrë aprovimin e Kuvendit si i tillë dhe se presin komentet e komunitetit të kulturës për vërejtjet, sugjerimet eventuale që të plotësohet edhe më shumë ky dokument, para se të dalë për miratim përfundimtar në njërin nga seancat e Kuvendit të Komunës.

Edhe drejtoresha e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Xhemile Murati-Shabani, ka thënë se për mirëfunksionimin e institucionit të teatrit është punuar ky dokument nga Këshilli Drejtues i Teatrit "Adriana", dokument

ky që përfundimisht do t'i zgjidhë telashet e deritanishme në këtë institucion.

Ndërsa anëtarë të trupës së aktorëve dhe drejtues të Teatrit "Adriana" parashtruan disa pyetje, komente, sugjerime përkritazi me këtë dokument, për të cilat morën përgjigjen nga anëtarë i Këshillit Drejtues të këtij institucioni, Albion Sherifi. Ky i fundit ka thënë se miratimi i këtij statuti që është dokument themelart i institucionit, tregues i vullnetit institucional dhe vendosmërisë të të parit të Ferizajt, Agim Aliu, që t'i japë drejtimin e duhur institucionit të teatrit, përmes kompletimit me bazën e nevojshme ligjore dhe aplikimit të politikave të mirëfillta kulturore. Ai, po ashtu, dha sqarime edhe për rolin e aktorëve me përvojë në këtë institucion, u interpretuan paragrafë të ndryshëm të këtij dokumenti për të cilat do të merren rekomandimet e nevojshme para propozimit për miratim në seancë të Kuvendit Komunal.



Vasfije Krasniqi-Goodman nderohet me titullin 'Emblema e Vushtrrisë'

VUSHTRRI, 19 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka pritur të premtën në takim Vasfije Krasniqi-Goodman, bashkëshortin e saj dhe familjen Krasniqi nga Vushtrria. Tahiri, si kryetar i Komunës së Vushtrrisë, i ka akorduar Vasfije Krasniqi-Goodman titullin "Emblema e

Vushtrrisë", me motivacionin "për guximin e jashtëzakonshëm, për thyerjen e stigmës dhe për përkrahjen e viktimave të dhunës çnjerëzore nga milicët serbë gjatë luftës së fundit në Kosovë". "Ishte një përvojë dhe ndjesi e jashtëzakonshme për ta takuar një grua që është bërë simboli i guximit dhe thy-

erjes së stigmës në Kosovë", ka thënë kryetari Tahiri.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka nderuar të enjten të mbijetuarën e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman, duke i dhënë titullin "Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës".



Banesa e Qëndron Kastratit iu dha familjes me gjendje të rëndë sociale

PRISHTINË, 19 TETOR (ER) - Në listën e kategorive të dala nga lufta për të cilat Komuna e Prishtinës kishte ndarë banesë vite më parë, ishte edhe familja e dëshmorit të kombit, Isa Kastrati. I biri i tij, tashmë kryetari i Kamenicës, Qëndron Kastrati, pasi u zgjodh në post

publik, e liroi banesën me kërkesë që ajo t'i ndahet ndonjë familjeje tjetër qoftë nga kategoritë e dala nga lufta, qoftë nga rastet sociale. Çelësat e asaj banese sot i ka Milazim Hasimi, i cili ishte i pari në listën e pritjes nga familjet me gjendje të rëndë sociale, për të siguruar

strehim në një banesë të tillë. "Duke falënderuar Kastratin për një veprim të tillë, urojmë që ky shembull të ndiqet edhe nga të tjerët, ashtu që banesat e tilla të jenë në dispozicion për familjet në nevojë", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Komuna e Prizrenit organizon aktivitete sensibilizuese me nxënës për ruajtjen e ambientit

PRIZREN, 19 TETOR (ER) - Aktivitetet për ngritjen e vetëdijesimit të nxënësve për mbrojtjen e ambientit dhe riciklimin e mbeturinave po vazhdojnë të organizohen në shkollat të ndryshme të qytetit. Së fundi këto aktivitete u organizuan në shkollat "Gjon Buzuku", "Mustafa Baku" dhe "Avdyl Frashëri" në Prizren.

Ky projekt që po organizohet në bashkëpunim ndërmjet sektorit

të mjedisit të Komunës së Prizrenit dhe GIZ-it do të vazhdojë deri në fund të vitit shkollor me aktivitete informative dhe kreative për nxënësit e shkollave të ndryshme të komunës sonë. Projekti do të implementohet me shpërndarjen e shportave të veçanta të mbeturinave për ndarjen e plastikës dhe letrës, si dhe do të bëhet prezantimi i të gjitha punimeve të realizuara.



Diplomacisë shqiptare për bisedimet me Greqinë: 'Mos mbaj gjithë vezët në një shportë'!



Prof. Lisen BASHKURTI

Deklarata e bërë kohë më parë nga Qeveria Shqiptare, se do të kemi "zero probleme me fqinjët", po rezulton e nxituar. Ndonëse shprehte në vetvete një dëshirë dhe vullnet të mirë për marrëdhëniet me fqinjët, këto janë të pamjaftueshme, sidomos në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo po vihet re në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet me Greqinë. Pas retorikës politike dhe ecejakeve diplomatike situata aktuale duket të jetë e ngrirë dhe në mjaft aspekte e paqartë. Dorëheqja e ish-ministrit të Jashtëm grek, Kotzias këto ditë, e ka mjegulluar edhe më keq perspektivën.

Mjerisht nuk mund të futemi në detajet e ecurisë së bisedimeve shqiptaro-greke të kohëve të fundit, të cilat do të kërkonin mirinformim nga diplomacia publike shqiptare, gjë që dukshëm mungon. Mungesa e transparencës ka krijuar një mjegullnajë informative, që na bën të konsiderojmë si burim analize vetëm deklaratat politike e burimet mediatike në dy anët e kufirit Shqipëri - Greqi.

Bazuar në deklaratat politike dhe burimet mediatike shqiptare dhe greke arrijmë në disa konkluzione, të cilat, ndonëse nuk mbështeten në burime të mjaftueshme informacioni, sërish tërheqin vëmendjen për mënyrën se si të dyja palët i janë qasur agjendës bilaterale. Të dyja palët kanë vënë në tryezën e bisedimeve një agjendë të shtrirë në një hark kohor gati një qindvjeçar dhe me rreth dhjetë problematika themelore. E gjithë kjo agjendë njëqindvjeçare me dhjetë probleme në qendër, thuhet se do të formalizohet me një sërë marrëveshjes në kuadër të një traktati të vetëm dy palësh.

Nga retorika politike e propagandistike kjo tërësi marrëveshjes në kuadër të këtij traktati të pritshëm serviret si zgjidhje e artë e gjithë problemeve të trashëgimisë historike, të tranzicionit dhe të atyre aktuale midis dy vendeve. Kemi

të bëjmë me probleme të kohës së Luftës së Dytë Botërore, me Ligjin e Luftës, me eshtrat e ushtarëve grekë, me demarkimin e kufirit tokësor, me delimitimin e kufirit detar, me aspekte të dokumenteve të emigrantëve shqiptarë, me çështjen e njohjes së patentave të makinave, me adresimin e problemit të toponimeve e me disa probleme të tjera.

Nga kjo agjendë e shtrirë njëshekullore dhe e stërmadhe në problematika tërheqin vëmendjen dy aspekte: së pari, fshirja nga agjenda e çështjes çame dhe, së dyti, përzierja e prioritetve madhore strategjike si delimitimi i kufirit detar Shqipëri - Greqi me prioritete të dorës së dytë e tretë pa rëndësi strategjike si, fjala bie, eshtrat e ushtarëve grekë apo patentat e shoferëve shqiptarë. E gjithë kjo "lëndë" po përfshihet brenda një procesi tej mase të shkurtër kohor. Thuhet, gjithashtu, se ky proces do të hapë një faqe të re në marrëdhëniet midis dy vendeve.

Diplomacia shqiptare tanimë duket se ka rënë në një kurth taktik diplomatik të rëndë që mund të ketë pasoja të riparueshme ose vështirësisht të riparueshme. Në negociatat me Greqinë diplomacia shqiptare ka futur "gjithë vezët në një shportë", pra ka luajtur me skenarin me rrezikshmërinë më të lartë.

Në këtë shportë çështje madhore janë fshirë, si çështja çame, ndërkohë që çështje strategjike, siç është delimitimi i kufirit detar, janë përzierë me çështje të dorës së dytë e tretë ose të konjunkturës, siç është njohja e patentave të shoferëve.

Qartazi kjo ka qenë taktikë diplomatike greke, me synimin që çështjet madhore të hiqen nga dosja diplomatike, ose çështjet strategjike të përzihen me çështje të rëndomta. Në këtë grackë duket se ka rënë diplomacia shqiptare.

Në këtë grackë 'uji i turbullt përzihet me foshnjën'.

Për diplomacinë greke agjenda shqiptaro-greke që përfshinë një hark kohor njëqindvjeçar dhe dhjetë problematika njëherësh, ose e thënë metaforikisht "gjithë vezët në një shportë", është disi më e lehtë. Në Greqi kemi të bëjmë me një diplomaci shtetërore gati dyqindvjeçare. Shkolla greke e diplomacisë është një mpleksje e ngritur mbi

trashëgiminë e diplomacisë një mijë vjeçare të Bizantit, e pasuruar me vlerat e diplomacisë së familjeve aristokrate Habsburge si dhe me shkollën diplomatike Britanike. Në një farë kuptimi shkolla greke e diplomacisë është nga më të vjetrat dhe më të konsoliduarat në Ballkan. Ajo ka dije, kulturë, profesionalitet, kontinuitet dhe përvojë për ta përballuar shtrirjen kohore njëqindvjeçare dhe tërësinë e problematikave në "një shportë të vetme".

Nga ana tjetër, edhe pozita ndërkombëtare e Greqisë është më e lartë dhe më e konsoliduar se e Shqipërisë. Prandaj, shkalla e rrezikut për diplomacinë greke është më e vogël.

Nga ana tjetër e tryezës, diplomacia shqiptare, për hir të vërtetës, duhet të pranojmë se është më e re, rreth njëqindvjeçare. Nga 1912-1928 diplomacia shqiptare ishte spontane, pa establishment, pa profesionalitet, pa përvojë dhe pa kontinuitet. Ndërkohë problematikave me fqinjët, përfshirë edhe Greqinë, akumuloheshin pambarimisht. Regjimi i Mbretit Zog brenda një kohe të shkurtër hodhi bazat e diplomacisë, por me një efikasitet të brishtë. Lufta e Dytë Botërore ndërpreu Mbretërinë Shqiptare e, bashkë me të, edhe diplomacinë e saj. Në regjimin komunist diplomacia shqiptare ishte instrument i indoktrinuar, i ideologjizuar dhe pjesë e makinerisë propogandistike të regjimit. Diplomacia e komunizmit u bë instrument i vetizolimit. Natyrisht, brenda sistemit të Luftës së Ftohtë diplomacia shqiptare arriti që të përballonte disa problematika dhe sfida, të cilat shërbyen si përvojë për një ardhje diplomatësh që u


kulturuan, u formuan dhe u aftësuan profesionalisht. Mbas viteve '90, gjatë transformimit të sistemit politik, ekonomik dhe shoqëror të vendit, diplomacia u bë tagër i goditjeve radikale politike, gjë që solli si pasojë dëmtimin e trashëgimisë, profesionalitetit dhe kontinuitetit të saj.

Rotacionet politike të tranzicionit shqiptar goditën herë pas here establishmentin diplomatik shqiptar. Ndryshimet e motivuara politikisht varrosën një pjesë të madhe të vlerave të diplomacisë shqiptare, duke e shndërruar atë shpesh në shtojcë të strukturave partiake dhe pjesë të politikave ditore. Diplomacia në një masë të madhe humbi establishmentin, profesionalitetin, përvojën, kontinuitetin dhe strategjinë afatgjatë. Sot një diplomaci e tillë e ka shumë të vështirë, në mos të pamundur, që të verë në tryezë një agjendë me hark kohor njëqindvjeçar dhe me dhjetë problematika njëherësh. Kohë më parë kemi ngritur këtë shqetësim në media. Reagimet zyrtare kanë qënë të zbehta. Tani që duket se ecuria e bisedimeve diplomatike Shqiptaro-Greke është e ngrirë dhe në mjaft aspekte e paqartë dhe kur kriza Greke pas dorëheqjes së Kotzias po prek edhe diplomacinë, po tërheqim sërish vëmendjen e diplomacisë shqiptare në marrëdhëniet me Greqinë: "Mos i mbani gjithë vezët në një shportë!"

Ky gabim taktik ka dy rreziqe të mëdha. Së pari, ai mund të shndërrohet në një krizë politike serioze në marrëdhëniet midis dy vendeve. Le të kujtojmë se Marrëveshja e Prespës midis Greqisë dhe Maqedonisë ka adresimin vetëm të një problemi

dhe ka prodhuar situatë shumë serioze dhe të paparashikueshme. Ndërkohë tekst - marrëveshjet Shqipëri-Greqi që synojnë të adresojnë një shtrirje kohore njëshekullore dhe shumë problematika njëherësh mund të shndërrohen nesër në një krizë politike shumë më serioze me pasoja për dy vendet dhe Rajonin si dhe me mundësi bllokuese nga Greqia të ecurisë së integritetit të Shqipërisë në BE. Nga ana tjetër, në kushtet e mungesës së Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri, kalimi në Parlament i tekstit të këtyre marrëveshjeve do ishte një veprim shumë i nxituar dhe me pasoja shumë të rënda dhe të paparashikueshme.

Në këtë situatë të komplikuar dhe tejte të paqartë vetëm presidenti i Republikës, z. Ilir Meta, po mban një qëndrim kushtetues, njëkohësisht parandalues e të matur e diplomatik. Sytë e politikës, opinionit publik e mediatik janë mbërthyer tek presidenti Meta. Vërtet presidenti Meta është garanti i Kushtetutës dhe mbrojtjes i unitetit dhe interesit kombëtar. Vërtet që presidenti Meta po luan fort edhe në diplomaci. Por, institucioni i Presidentit nuk mund të shndërrohet as në Gjykatë Kushtetuese dhe as në shërbim diplomatik. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka qartazi të përcaktuara kompetencat e presidentit, ato të Gjykatës Kushtetuese dhe të ekzekutivit ku bën pjesë diplomacia. Dhe presidenti Meta me formimin dhe përvojën e gjatë politike, administrative dhe diplomatike po vepron brenda kompetencave të veta kushtetuese. As më shumë dhe as më pak.



Trumpi fajëson demokratët për valën e emigracionit të paligjshëm



UASHINGTON, 19 TETOR - Presidenti Donald Trump kërcënoi se do të dërgojë ushtrinë për të mbyllur kufirin jugor të Shteteve të Bashkuara, nëse Meksika nuk ndal mijëra emigrantë nga Amerika Qendrore që synojnë të hyjnë në ShBA. Çështja e emigracionit pritet të diskutohet në Mexico City gjatë takimit të Sekretarit amerikan të Shtetit, Mike Pompeo, me presidentin mexikan në largim, Pena Nieto.

Me vetëm pak javë deri në zgjedhjet për Kongresin, presidenti Trump u tha mbështetësve gjatë një tubimi në Montana se fajin e kanë demokratët për valën e emigracionit të paligjshëm. Ai u duk madje se bëri një lidhje mes politikës dhe kohës së organizimit të karvanit të emigrantëve. "E dëshironin këtë karvan dhe ka njerëz që thonë se nuk u krijua vetiu. Nuk u shfaq thjesht;

ka shumë arsye për këtë karvan me 4 mijë veta. Megjithatë, dua të falënderoj Qeverinë mexikane, e cila shpresoj që do t'i ndalë përpara se të mbërrijnë", tha presidenti Trump. Meksika dërgoi të enjten qindra policë shtesë në kufirin e saj me Guatemalën. Presidenti Trump pretendon se ka kriminelë mes gati 3 mijë hondurasve që udhëtojnë përmes Guatemalas, drejt Meksikës dhe rrjedhimisht drejt ShBA-së.

Zgjedhjet në Afganistan, shqetësime për sigurinë dhe mashtrimet

Këto do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare qëkur talibanët u rrëzuan nga pushtet në vitin 2001, të cilat është dashur të mbahen kur mandati pesëvjeçar i Asamblesë aktuale ka përfunduar në vitin 2015. Por, bllokada pas zgjedhjeve të diskutueshme presidenciale të vitit 2014 ka ndryshuar gjithçka, duke e çuar vendin në prag të luftës civile

KABUL, 19 TETOR - Afganët edhe një herë do të sfidojnë kërcënimet, pasigurinë dhe frikën dhe do të votojnë në zgjedhjet parlamentare të 20 tetorit. Shumica e tyre janë të etur për një jetë më të mirë, punë, edukim dhe për një fund të luftës me talibanët.

Këto do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare qëkur talibanët u rrëzuan nga pushteti në vitin 2001.

Ato është dashur të mbahen kur mandati pesëvjeçar i Asamblesë aktuale ka përfunduar në vitin 2015. Por, bllokada pas zgjedhjeve të diskutueshme presidenciale të vitit 2014 ka ndryshuar

gjithçka, duke e çuar vendin në prag të luftës civile.

Është dashur ndërhyrja e Shteteve të Bashkuara atëbotë për t'i hapur rrugë formimit të qeverisë aktuale të unitetit kombëtar: me Ashraf Ghanin president dhe me rivalin e tij kryesor, Abdullah Abdullah, kryeshf ekzekutiv.

Të dyja palët kanë rënë dakord për një rishikim gjithëpërfshirës të sistemit zgjedhor.

Zgjedhjet e sotme (e shtunë) do të jenë një test për reformat e ndërmarra dhe për aftësitë e Komisionit Zgjedhor, i cili është kritikuar për dështim në organizimin e zgjedhjeve të lira dhe të



drejta.

Zgjedhjet janë të parat që nga përfundimi i misionit luftarak të NATO-s në Afganistan në vitin 2014.

Përgjegjësia e sigurisë bie kryesisht mbi forcat afgane, ndërsa Misioni i Mbështetjes i NATO-s do të veprojë kur t'i kërkohet.

Por, sipas një studimi të BBC-së, të publikuar këtë vit, talibanët janë aktivë në mbi 70% të territorit të Afganistanit dhe sfidat e

sigurisë, thonë vëzhguesit, nuk janë të lehta.

Talibanët u kanë kërkuar qytetarëve që t'i bojkotojnë zgjedhjet e së shtunës, duke i quajtur "të rreme", dhe militantët e Shtetit Islamik në Afganistan e kanë ndjekur shembullin.

Prejse janë shpallur zgjedhjet, ka pasur disa sulme në qendrat e regjistrimit të votuesve. Më vdekjeprurësi, me gati 60 njerëz të vrarë, ka ndodhur në muajin prill

në Kabul dhe përgjegjësinë për të e ka marrë Shteti Islamik.

Së paku dhjetë kandidatë janë vrarë në sulmet në gjithë vendin. Në zgjedhjet e mëparshme, rreth 10% e qendrave të votimit janë mbyllur për shkak të shqetësimeve për sigurinë. Këtë herë, rreth një e treta e më shumë se 7,000 qendrave do të mbyllen. Por, siguria nuk është çështja e vetme që kërcënon votimin. Zgjedhjet e kaluara janë dëmtuar nga korrupsioni dhe mashtrimet, me raste të mbushjes së kutive të votimit apo të votimit të shumëfishtë.

Në zgjedhje garojnë mbi 2,500 kandidatë, që do të thotë së paku 10 vetë për një ulëse në Parlament.

Rreth 8.8 milionë njerëz janë regjistruar për të votuar. Megjithëse nuk ka pasur regjistrim të popullsisë për më shumë se 30 vjet, në Afganistan vlerësohet se jetojnë më shumë se 30 milionë banorë.

Rusia ndërton central bërthamor në Uzbekistan



MOSKË, 19 TETOR - Presidenti rus Vladimir Putin dhe homologu i tij i Uzbekistanit, Shavkat Mirziyoyev, kanë rënë dakord që Rusia të ndërtojë centralin e parë bërthamor në këtë ish-republikë sovjetike.

Marrëveshja është arritur gjatë vizitës së Putinit në Tashkent të premten, ky dy burrëshetësit urdhëruan fillimin e punës përgati-

tore në lokacionin e ardhshëm. Sipas vlerësimeve, centrali i ri që do të ndërtohet në rajonin Navoi, do të ketë koston prej rreth 11 miliardë dollarë. Uzina do të ketë dy reaktorë bërthamorë me kapacitet prej 1.200 megavat, ndërsa me punë do të fillojë në vitin 2028.

Putini nga ana e tij tha se Moska është e gatshme t'i zgjerojë lidhjet e teknologjike dhe ushtarake me

Tashkentin zyrtar, përfshirë edhe mundësinë e prodhimit të përbashkët të armëve, raporton Anadolu Agency.

Mirziyoyev ndërkohë, deklaroi se kompanitë ruse dhe ato uzbekë, mund të zgjerojnë bashkëpunimin edhe në sferën e tekstilëve dhe plehrave duke i shitur produktet në tregun ndërkombëtar.

Rrëzohet një helikopter i Marinës amerikane

UASHINGTON, 19 TETOR - Një helikopter i Marinës amerikane u rrëzua të premten në kuvertën e fluturimit të aeroplanmbajtëses amerikane "Ronald Reagan", duke shkaktuar plagosjen e disa marinarëve.

Në një deklaratë të flotës së 7-të të marinës thuhej se helikopteri MH-60 Seahawk u rrëzua menjëherë pas ngritjes të premten në mëngjes, ndërsa

aeroplanmbajtësja ishte larguar nga bregu i Filipineve.

Gjendja shëndetësore e të gjithë marinarëve të plagosur është e qëndrueshme dhe asnjë prej tyre nuk ka marrë dëmtime që u kërcënojnë jetën. Por në deklaratën e marinës nuk thuhej numri i marinarëve të plagosur. Sipas saj disa prej tyre do të marrin trajtim mjekësor pasi të arrijnë breg, por pa u përcaktuar se

ku.

Marina nuk dha detaje rreth dëmtimit të helikopterit apo aeroplanmbajtëses, por tha se anija ishte plotësisht e aftë për të kryer misionin e saj për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin e Indo-Paqësorit. Nga momenti i aksidentit në aeroplanmbajtëse kanë rifilluar fluturimet. Shkaqet e rrëzimit të helikopterit janë ende nën hetim.



Gra që ju kanë bërë krahë ecjes sonë nëpër rrugët e historisë

(Hanëmshahe Ilazi, "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës, Prishtinë, 2018)



Prof. dr. Nusret PLLANA

Përkufizimi

Tema e veprës së Hanëmshahe Ilazit është shumë interesante edhe për faktin se sjell dëshmi të mjaftueshme qoftë për gratë nga vende të ndryshme të botës, që janë marrë me jetën historike dhe me jetën e brendshme të shqiptarëve, qoftë për angazhimin e grave shqiptare të mërgatës që kanë dhënë çdo gjë vetëm të mos harrohet emri i popullit nga i cili vijnë.

Qoftë vetëm për këto fakte, vepra e Hanëmshahe Ilazit mundëson që lexuesi shqiptar të njihet me rrugën e madhe të jetës historike nëpër të cilën ka kaluar populli shqiptar, në të njëjtën kohë bëhet dëshmitar i angazhimit të madh edhe të femrës nga Evropa dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për ta mbështetur, për ta përkrahur, për ta bërë të njohur dhe, në fund të fundit, për t'u bërë zëdhënës e jetës së popullit tonë nëpër tragjeditë e jetës sonë historike, të cilat, të shumtën e herëve, brenda tragjikes ruanin edhe madhësitë e njerëzve nëpër ato ngjarje.

Gratë, që janë bërë subjekt i veprës së Hanëmshahe Ilazit, secila më e njohur se tjetra, nga vende të ndryshme të botës kanë vënë në shërbim të lirisë sonë, të luftërave të drejta të popullit tonë jo vetëm dijen e tyre, por edhe angazhimin konkret në përpjekje për ta bërë të njohur gjendjen reale të popullit shqiptar para opinionit botëror.

Hyrje

Autorja e veprës "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës", krijuesja e njohur, Hanëmshahe Ilazi, ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për angazhimin e grave për çështjen shqiptare qoftë nga anë të ndryshme të botës, qoftë ato me origjinë shqiptare që kanë jetuar dhe kanë vepruar kudo jashtë trojeve shqiptare, qoftë të grave shqiptare që kanë vënë krijimtarinë e tyre, veprimtarinë e tyre në shërbim të atdheut të tyre, Shqipërisë.

Mënyra e ndërtimit të strukturës së veprës së saj i ka dhënë dorë ta sistemojë brenda veprës së saj, gra që kanë punuar për të drejtën historike të popullit shqiptar, gra që kanë qenë pjesëmarrëse nëpër ngjarje të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar gjatë historisë, gra që kanë vënë në shërbim të çështjes shqiptare, dijen, angazhimin, punën e madhe

intelektuale si dhe veprimtarinë e madhe publike, vetëm që të ndriçohen aspekte të ndryshme të jetës së popullit tonë nëpër periudhat kohore, qoftë kur kanë ndodhur ngjarje të caktuara, qoftë kur pritej të ndodhnin zhvillime me pasoja tragjike për jetën e këtij populli.

Autorja e veprës publicistike, "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës", varësisht se me cilën figurë të grave, për të cilën ka shkruar, ka shpaluar edhe zhvillime të ndryshme të ngjarjeve nëpër të cilat ato kanë dhënë ndihmesën e tyre, që të kuptohet drejt çështja shqiptare për të cilën ato ishin angazhuar.

Gra të huaja, pjesë e historisë së popullit shqiptar

Gratë për të cilat ka shkruar autorja Hanëmshahe Ilazi janë të shumta dhe janë të periudhave të ndryshme kohore. Prandaj, edhe ngjarjet për të cilat janë angazhuar ato kanë qenë pjesë e tyre, i kanë bërë të njohura, qoftë në opinionin e vendeve të tyre, qoftë në mjedis të tjera në përmasë botërore, duke u vënë në anën e drejtësisë historike, si me angazhimin e tyre politik, si me dijen e tyre intelektuale, si me përpjekjet e tyre për ta ndihmuar popullin shqiptar, nëpër rrënojat e historisë që i kishin rënë hise e jetës së tyre historike.

Autorja Hanëmshahe Ilazi ka të drejtë kur shpreh mendimin se populli shqiptar është "borxhlinj ndaj këtyre grave trime, mendje ndritura e shumë humane, që bënë shumë për popullin dhe vendin tonë, duke filluar nga fundshekulli XIX, fillimshekulli XX, duke vazhduar deri në shekullin XXI e më tutje deri në ditët tona", jo vetëm për faktin se veprimi i tyre politik, dija e tyre intelektuale, veprimtaria humanitare e secilës nga ato ishte bërë pjesë e jetës së këtij populli, por edhe për faktin se me angazhimin dhe përpjekjet e tyre ato kishin vënë në lëvizje opinionin e vendeve të tyre, politikën e shteteve nga kishin ardhur, por edhe kishin informuar drejt e pa anime opinionin e atyre vendeve, gjë që edhe sot del se është shumë me rëndësi për rrugën e historisë së popullit shqiptar.

Periudha kohore e pranisë së grave të huaja, siç thotë autorja, përfshinë thujse tre shekuj të jetës historike dhe të jetës shpirtërore të këtij pop-

ulli. Vetëm ky fakt është i mjaftueshëm për ta parë punën e madhe qoftë në grumbullimin e të dhënave për secilën nga këto personalitete, qoftë për t'i dokumentuar përpjekjet e tyre nëpër ngjarje të caktuara, qoftë për të afruar fakte dhe njohuri të reja për shumë nga këto gra që kishin vënë dijen dhe veprimin e tyre praktik në shërbim të ndriçimit të aspekteve të ndryshme të ngjarjeve historike të cilat kishin qenë pjesë e popullit shqiptar që nga shekulli XIX e deri në qershor të vitit 1999, kur mbyllet një kapitull i madh i padrejtësive historike nëpër të cilat kishte jetuar populli shqiptar.

Jorastësisht andaj, autorja e veprës "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës" e fillon veprën me një figurë shumë të rëndësishme jo vetëm për historinë e popullit shqiptar, sidomos për historinë e Kosovës, si pjesë e historisë shqiptare, siç është figura e politikanës me ndikim botëror, Angela Merkel, e cila me angazhimin e saj për zgjidhjen e jetës politike të Kosovës, ka vënë në udhën e mbarë të zgjidhjes, thujse tërësinë e politikës shqiptare.

Duke qëmтуar nëpër faqet e historisë së popullit tonë, autorja e veprës "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës" shqyrtonim e figurave të grave që i janë bërë krahë çështjes shqiptare, e ka trajtuar në disa plane, duke filluar nga ai politik, nga veprimtaria shumë e frytshme e shumë grave të botës, për ndriçimin e çështjeve jetësore të popullit shqiptar, siç janë dijet për origjinën e popullit shqiptar dhe origjinën e gjuhës shqipe, do të thotë, aspekte nga më të ndryshmet të studimeve albanologjike, më tutje, veprimtarinë humanitare të atyre grave, të cilat, përkundër pengesave të mëdha që u dilnin nga politika e vendeve të tyre, kishin arritur ta informojnë opinionin botëror me tragjedinë që po i ndodhte popullit shqiptar.

Njëra nga këto figura, të cilën historia dhe kultura jonë e ka pagëzuar "Mbretëresha e malësorëve", është Edith Durham, e cila jo vetëm me veprën e saj historike, etnografike, me studimin e dokeve dhe zakoneve të jetës së brendshme të shqiptarëve të "Malësisë së Veriut", por edhe me angazhimin e saj të drejtpërdrejtë politik, kudo ku i jepej rasti dhe kudo ku kishte ndikim, ka bërë që ngjarje të caktuara të his-

torisë sonë të fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, të bëhen pjesë e informacionit të opinionit politik dhe shoqëror evropian. Qoftë vetëm trajtimi, paraqitja, informacioni për veprimtari të këtyre grave të huaja që janë vënë në shërbim të çështjes shqiptare, veprës së autores Hanëmshahe Ilazi i jep vlerë të mirëfilltë të publicistikës historike.

Duke qëmтуar praninë e këtyre grave, nga vende të ndryshme të Evropës dhe të botës, autorja Hanëmshahe Ilazi ka sistemuar informacion të shumtë për gratë e huaja që u kanë dhënë ndihmesë zhvillimeve të ndryshme, historike, kulturore dhe shkencore të jetës së popullit shqiptar. Në veprën e saj kanë zënë vend kontributet e këtyre grave në shumë plane të jetës së popullit tonë, siç janë: Margaret Hasluck, Rose Wilder Lane, Kontesha Carnarvon, Nina Smirova, Agnia Vasilievna Desnickaja, Marina Marinova, Mariane Graff, Larisa Kaminckaja, Gertruda Entrei, Shirley Dioguardi, Madeleine Olbright, Margaret Thaçer, Marie Calvin, Berit Beker, Alexandra Boulet, Angela Merkel, Anna Di Lellio, Nataša Kandić, Sonja Biserko. Përveç këtyre emrave që sollëm si shembëllim të pranisë së veprimtarisë së grave të huaja në jetën e popullit shqiptar, ka edhe shumë të tjera, siç thotë autorja, "nga shtete e kombe të ndryshme të botës, ku janë përfshirë gra angleze, amerikane, gjermane, ruse, bullgare, rumune, kroate, italiane, serbe, franceze, austriake" e kështu me radhë, një veprimtari shembullorë, krahas veprimtarisë së veprimtarëve, dijetarëve, politikanëve dhe studiuesve burra, që kanë dhënë ndihmesë të pamatshme për shumë çështje të jetës historike dhe shpirtërore të popullit tonë.

Gra të mërgatës shqiptare që i bëhen krahë atdheut

Një pjesë të konsiderueshme të veprës së saj, "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës", autorja Hanëmshahe Ilazi ia ka kushtuar edhe rolin shumë të madh, praninë së përhershme, aktiviteteve dhe veprimtarive të pafundme të grave të mërgatës shqiptare kudo nëpër botë. Mjafton vetëm të zihet në gojë emri i Elena Gjijkës, e njohur në botën shken-

core dhe kulturore të Rilindjes evropiane dhe shqiptare, me emrin artistik Dora d' Istria, e cila për herë të parë, si studiuese femër, e informon opinionin kulturor evropian për origjinën e popullit shqiptar sipas këngëve popullore shqiptare, të mbledhura nga shumë studiues, sidomos nga arbëreshët tanë.

Në planin e veprimtarisë humanitare, cila grua e botës mund të krahasohet me nënën tonë të madhe, Gonxhe Bojaxhiu - Shën Terezën (Nënë Terezë), që është bërë Nënë e Botës. Po ashtu, në veprën e saj është folur dhe është shkruar edhe për kapitenen e parë të anijeve në Evropën e kohës, për Bubulinën tonë, për të cilën kanë shkruar vepra edhe autorë të huaj, kurse ne, aq pak kemi folur për të. Këtu, siç ndodh zakonisht në shkrime të kësaj natyre, nuk është e mundur të përmenden të gjitha ato personalitete të grave të mërgatës shqiptare, apo të grave të huaja që janë bërë pjesë e jetës historike dhe kulturore të popullit shqiptar, por autorja ka qëmтуar me kujdes dhe me shumë durim, aq shumë informacion kulturor e shkencor, për të përkufizuar bindshëm praninë e madhe në jetën e popullit shqiptar, të grave nga vende të ndryshme të botës, si dhe të grave të mërgatës shqiptare, që asnjëherë nuk e kanë harruar atdheun e origjinës, Shqipërinë.

Përfundim

Siç është theksuar edhe në fillim të këtij shkrimi, në strukturën e ndërtimit të veprës së autores Hanëmshahe Ilazi, "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës", janë shtresuar të dhëna dhe informacion kulturor për, thujse, dy grupe të grave, të grave të huaja, nga aq shumë vende të botës, që kanë marrë pjesë në ngjarje shumë të rëndësishme në jetën historike të popullit shqiptar, si dhe gra të mërgatës shqiptare, të cilat me veprimtarinë e tyre atdhetare, kulturore, shkencore, sportive, humanitare, kanë bërë të njohur përkatësinë e tyre kombëtare kudo në botë, por edhe kanë hapur mundësi e rrugë për angazhimin e të tjerëve në zgjidhjen e aq shumë aspekteve të jetës historike të popullit shqiptar. Qoftë vetëm për angazhimin e madh lidhur me informacionin që ka shtrirë në veprën e saj, autorja Hanëmshahe Ilazi, njohjes së figurës së gruas nga vende të ndryshme të botës, që kanë dhënë ndihmesën e tyre për njohjen e çështjes shqiptare, njohjes së angazhimit të gruas së mërgatës shqiptare, që jo vetëm kanë ruajtur përkatësinë e identitetit kombëtar, por kanë hapur rrugë komunikimi e informimi kudo në botë për çështjen shqiptare, dëshmon për rëndësinë dhe vlerën e veprës "Gratë e huaja për shqiptarët dhe shqiptaret e diasporës".



E rrallë

Stjuardesa vjedh mbi 4 mijë dollarë nga pasagjerët

Një stjuardesë në Emiratet Arabe është akuzuar për vjedhjen e parave të dy pasagjerëve. Gjatë fluturimit, mendohet se ajo ka vjedhur para me vlerë mbi 4 000 dollarë nga kuletat e dy vëllezërve që ishin çuar nga vendet e tyre në avion për ta ndihmuar babanë e tyre të sëmurë.



Gjatë seancës gjyqësore, vëllezërit e moshës 35 dhe 43 vjeç raportuan se paratë e vjedhura ishin në portofol.

FOTO E DITES



Duka dhe dukeshja e Sussexit flasin me studentët derisa udhëtojnë me një tramvaj, në Melburn të Australisë.
/Fotografia: Chris Jackson, Getty Images/

E jashtëzakonshme

Bën biskota me hirin e gjyshit të vdekur

Një studente në Kaliforni hodhi pluhurin e trupit të gjyshit të vdekur në brumin e biskotave të bëra vetë dhe më pas ua dha shokëve të klasës. Incidenti makabër ka ndodhur në Kaliforni, pranë Akademisë DaVinci Charter në



Davis, ku vajza e ndihmuar nga shoja e saj ua dhanë biskotat nëntë shokëve të klasës.

BARSOLETA E DITËS



Vajza: Babi, po shkoj te shoja që të mësoj.
Babi: Kështu edhe nëna jote u thoshte prindërve, po vinte tek unë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Sot do të korrighoni disa veprime të nxituara që keni marrë në të shkuarën. Janë gjëra që mund t'ju prishnin shumë punë nëse nuk zgjidheshin.</p>	 <p>DEMI Në ambientet që frekuentoni vazhdimisht do të gjeni njerëz që ndajnë të njëjtat ide si ju. Bashkë mund të bënit një skuadër fituese në çdo gjë.</p>	 <p>BINJAKËT Sot jeni i justifikuar nëse shpenzimet tuaja kanë për qëllim dhuratat për personat e dashur. Gjithmonë ju kanë akuzuar se jeni egoist në shpenzime.</p>	 <p>GAFORRJA Fantazia e shfrenuar sot do t'ju ndihmojë të harroni për pak momente problemet që ju kanë mbushur ditën. E keni gjetur si rrugë shpëtimi këtë gjë.</p>	 <p>LUANI Sot edhe pse nuk keni qejf të punoni shumë alternativa interesante do të zgjojnë tek ju ambicien e dikurshme. Do t'i tregoni vetes që ia dilni me pak punë.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Edhe pse në familje ka debate, ju do të dini se si ta riktheni harmoninë e dikurshme. Çdo gjë do të qetësohet gjatë pjesës së dytë të ditës.</p>
 <p>PESHORJA Sonte nuk keni pse mërzhiteni sepse keni marrë disa ftesa shumë interesante. Ju mjafton vetëm të zgjidhni se ku do të shkoni.</p>	 <p>AKREPI Argëtohuni sot duke hequr mendjen nga gjithçka që ju ka shqetësuar kohët e fundit. Miqtë do të dinë se si t'ju bëjnë t'i harroni problemet.</p>	 <p>SHIGJETARI Disa keqkuptime të vogla do ta ndryshojnë komplet thelbin e bisedës sot. Nuk do të jeni në gjendje të sqaroni atë çka donit të thoshit.</p>	 <p>BRICJAPI Këshillat e mira merren gjithmonë në konsideratë. Këtë do të bëni edhe ju sot sepse e dini mjaft mirë që personat që po jua japin ju duan të mirën.</p>	 <p>UJORI Doni të niseni sa më parë në udhëtimin që keni planifikuar dhe dita e sotme ju favorizon për këtë gjë. Shijoni çastet larg punës suaj.</p>	 <p>PESHQIT Tensione në vendin tuaj të punës që nuk ju lënë rehat, por nga ana sentimentale gjithçka shkon mirë dhe partneri është mbështetësi juaj kryesor.</p>

E dashura e Neymarit, një "marinare" seksi



Neymar derdh djersë në fushë, ndërsa e dashura e tij Bruna Marquezine relaksohet në bregdet. Modeluesja dhe aktorja braziliane duket se po i shijon në maksimum këto ditë pushimi me miqtë e saj. Madje

23-vjeçarja këtë e ka treguar edhe përmes disa fotografive dhe videove të publikuara në 'Story' të 'Instagram'. Bruna shihet në një formë tepër të mirë, edhe pse fansat e kanë kritikuar pak muaj më parë për fizikun e dobët.

Cardi B paralajmëron këngën e re



Reperja e famshme Cardi B ka paralajmëruar se shumë shpejt do ta publikojë projektin më të ri. "Money" titullohet projekti i ri i reperes

që pritet të lansohet më 26 tetor. Cardi më parë ka pranuar se po punon në projekte të reja që nuk janë pjesë e albumit debutues, "Invasion of Privacy".



Rita Ora veshur plot ngjyra


Ajo është gjithmonë një hap para për sa iu përket tendencave të modës. Së fundmi, ylli shqiptar është fotografuar në Londër, veshur plot ngjyra. Rita Ora dukej

mjaft interesante veshur me një bluzë të kuqe, fund rozë dhe një xhakëtë të zezë të madhe. 27-vjeçarja u tregua u guximshme me këtë veshje e cila nuk u pëlqye nga të gjithë.

Pete ndihet kaq keq pas ndarjes me Ariana Granden

Pete Davidson duket njeri i pafat qëkur është ndarë nga Ariana Grande. Ai u fotografua kur arriti në shtëpinë e nënës së tij, i veshur me rroba sportive dhe duke e mbajtur telefonin në dorë. Kjo është hera e parë që është parë në publik që nga lajmi i ndarjes dhe pamja në të cilën u pa, na la vetëm me ndjenjën e keqardhjes për të. E vështirë të vërehet nga fotoja, por Pete duket se ende mban tatuazhin kushtuar Arianës në dorën e tij.





Shpallje Publike

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Seksionin V Pikën 3 (c) të Rregullores së KEK-ut Sh.a dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës në Divizionet e KEK-ut, Divizioni i Burimeve Njerëzore, më 19.10.2018 publikon ofertën për pozitat e mëposhtme:

1. Analist për tarifa

(1 kryerës)

Në Zyrën për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Kandidati i suksesshëm duke i raportuar drejtpërdrejt Menaxherit për Tarifa dhe Analiza është përgjegjës për sigurimin e analizave profesionale për të gjitha çështjet tarifore lidhur me Zyrën për Tarifa dhe Çështje Rregullative. Asistimi në përgatitjen rregullimit të vendosjes së tarifës vjetore nën legjislacionin e tanishëm dytësor. Asistimi i Menaxherit sipas kërkesës në lidhje me të gjitha punët në sektorin e Kërkesave të Hyrave. Koordinimi me të gjitha departamentet e KEK-ut në lidhje me marrjen e të gjitha të dhënave dhe informatave të vendosjes së tarifave, raportimeve të rregullatave dhe të gjitha kërkesat për të dhëna dhe informata nga ZRE-ja.

Marrëdhëniet: Bashkëpunon me Menaxher për Tarifa dhe Analiza dhe shërbimet tjera në Divizione dhe subjektet tjera në KEK.

Autorizimet: Qasje në te dhenat dhe dokumentacionin për tarifa.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja superiore-Fakulteti Ekonomik

Shkathësi profesionale të komunikimit verbal dhe me shkrim si dhe aftësi ndër-personale të jetë në gjendje të punoj i pavarur dhe në ekip.

2. Zyrtar për Licencim dhe raportim

(1 kryerës)

Në Zyrën për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Bartësi i vendit të punës ndihmon Specialistin për Licencim dhe Raportim për menaxhimin të gjitha aktiviteteve që caktohen nga ana e Drejtorit. Ndihmon Specialistin për Licencim dhe Raportim në përfaqësimin e KEK-ut me KEDS dhe KOSTT e MZHE lidhur me çështjet me licencim raportim e monitorim etj.

Bashkëpunon me specialistin në përgatitjen e raporteve vjetore, mujore, javore dhe ditore.

Ndihmon Specialistin në përfaqësimin e KEK-ut gjatë takimeve të ndryshme rreth çështjeve të ndryshme në aspektin ekonomik.

Koordinon punët me gjithë departamentet e KEK-ut në marrjen e të gjitha të dhënave dhe informatave për kryerjen e detyrave. Ndihmon kolegët nga departamentet tjera gjatë proceseve tarifore dhe raportimeve mujore, tremujore dhe vjetore.

Përgatit raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore rreth prodhimit të energjisë elektrike, kapacitetit në dispozicion për secilin njësi gjeneruese për palët e interesit dhe ja përcjell Specialistit për Licencim dhe Raportim.

Ofron ndihmë ekonomike Specialistit për Licencim dhe Raportim për dosjet e rregullatave

Ofron ndihmë në përkrahje rreth marrëdhënieve me publikun dhe për Departamentin e Çështjeve Rregullative. Koordinon MP me Departamentin gjegjës të KEK-ut.

Ndihmon Specialistin për Licencim dhe Raportim rreth analizës dhe raporton mbi përputhshmërinë dhe mospërputhshmërinë sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit që janë në fuqi. Si dhe detyrat tjera që caktohen nga Specialisti për Licencim dhe Raportim dhe nga Drejtori i Zyrës për Tarifa dhe Çështje Rregullative.

Marrëdhëniet: Bashkëpunon me gjithë personelin e Divizionit financiar, për punën e vet i raporton Specialistit për Licencim dhe Raportim.

Autorizimet: Punëmarrësi duhet t'iu përmbahet urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna nga Specialisti për licencim dhe Drejtori për Çështje Rregullative.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja superiore-Fakulteti Ekonomik.

Shkathësi profesionale të komunikimit verbal dhe me shkrim si dhe aftësi ndër-personale të jetë në gjendje të punoj i pavarur dhe në ekip.

3. Zyrtar për planifikim

(1 kryerës)

Në Zyrën për Tarifa dhe Çështje Rregullative

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për të gjitha punët që kanë të bëjnë me planifikim.

Bëjnë vlerësimin profesional, koordinon, bashkëpunon me Specialistin për planifikim dhe faturim

Bëjnë identifikimin dhe analizimin e të gjitha raporteve të leximit, raportet e realizimeve (prodhimit të energjisë) në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore.

Bashkëpunon ngushtë në përgatitjen e kërkesave vjetore, mujore, javore dhe ditore që duhet dorëzuar lidhur me planifikim dhe nominim të energjisë elektrike dhe kapacitetit.

Koordinon punët me gjithë departamentet e KEK-ut në marrjen e të gjitha të dhënave dhe informatave për kryerjen e detyrave. Ndihmon kolegët nga departamentet tjera gjatë proceseve tarifore dhe raportimeve mujore, tremujore dhe vjetore.

Përgatit raportet ditore, javore, mujore dhe vjetore rreth prodhimit të energjisë elektrike, kapacitetit në dispozicion për secilin njësi gjeneruese.

Modulimi i raporteve në baza ditore për planifikim

Analizimi dhe përgatitja e raporteve për planifikimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe kapacitetit në dispozicion me realizimin e prodhimit dhe kapacitetit në dispozicion në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore!

Si dhe detyrat tjera që caktohen nga Specialisti për planifikim dhe faturim dhe Drejtori për Çështje Rregullative.

Marrëdhëniet: Bartësi i vendit të punës bashkëpunon me Specialistin për Planifikim dhe faturim dhe me të gjithë personat tjerë në KEK të cilët kanë të bëjnë me Çështjet Rregullative.

Autorizimet: Punëmarrësi duhet t'iu përmbahet urdhrave dhe udhëzimeve të dhëna nga Drejtori për Çështje Rregullative.

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja superiore-Fakulteti Ekonomik.

Shkathësi profesionale të komunikimit verbal dhe me shkrim si dhe aftësi ndër-personale të jetë në gjendje të punoj i pavarur dhe në ekip.

4. Përcjellës i shiritave për qymyr në TCA

(6 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës kryen punën në përcjelljen e shiritave të thëngjillit dhe pastrimin e tyre

Është i obliguar të bëjë pranim dorëzimit e detyrave në vendin e punës, vërtetohet për gjendjen e pajisjeve nga kolegu paraprak me informata gojore

Në rast të mos ardhjes së kolegut pasues është i obliguar të vazhdoj ndërrimin

Përcjell punën e shiritave transportues të thëngjillit

Intervenon në çkyqjen e shiritit në rast të mbylljes apo defekteve eventuale

Banën pastrimin e vendit të punës, të hinkave gjatë mbylljes

Për probleme eventuale lajmëron udhëheqësin e ndërrimit

Është i obliguar të kryej të gjitha punët tjera të cilat ia parashtrojnë udhëheqësi i ndërrimit duke marr parasysh sigurinë

Në rast të treziqeve merr masat e domosdoshme për sigurinë e pajisjeve

Është i obliguar të përdor mjetet mbrojtëse në punë dhe pajisjet MKZ

Kryen edhe punë të tjera që i epen nga udhëheqësi

Marrëdhëniet: Është në kontakt të drejtpërdrejt me udhëheqësin e ndërrimit i cili i raporton për probleme eventuale dhe merr urdhra nga ai

Autorizimet: Është i pa varur në lëshimin e shiritave në punë duke e përcjellur sigurinë teknologjike

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja e mesme shkollore

5. Teknik Operator në DPQ

(1 kryerës)

Qëllimi dhe fushëveprimi i vendit të punës:

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për kryerjen e punëve teknike dhe administrative në kuadër të Sektorit Pranon detyrat e punës me gojë dhe me shkrim nga udhëheqësi i Sektorit

Është përgjegjës për kompletimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave dhe shënimeve të cilat pranohen nga udhëheqësit me të cilët bashkëpunon.

Pranon shënime nga inxhinieret operativ, udhëheqësit e sektorëve të cilat i përpunon në kompjuter.

Vërteton saktësinë e të gjitha shënimeve e te cilave i mere.

Plotëson raporte dhe skema të ndryshme

Operon me kompjuter, dhe të gjitha shënimet duhet të jenë të sakta dhe te sistemuara në mënyrë racionale.

Merr të gjitha masat e nevojshme për mirëvajtjen e kompjuterit dhe pasjeve.

Kryen edhe pune te tjera në kuadër të kualifikimit.

Marrëdhëniet: I raporton Udhëheqësit të Sektorit

Autorizimet: Tekniku operatore punët dhe detyrat e punës duhet ti kryej me korrektesë dhe sipas normave të kodit të etikës

Kërkesat profesionale/ Kualifikimet dhe aftësitë e duhura:

Përgatitja e mesme Teknike - Elektroteknik i Informatikës

Tri vite përvojë pune.

Njohja e mire e punës me kompjuter në WORD dhe EXEL

Divizioni i Burimeve Njerëzore, fton të gjithë të interesuarit të aplikojnë për pozitat e publikuara

Për hollësitë e mëtejshme për pozitat e lartpërmendura shikoni në faqen e internetit të KEK-ut www.kek-energy.com.

Aplikacionet mund të merren në faqen tonë të internetit www.kek-energy.com dhe dërgohen në adresë ofertapune@kek-energy.com, pranë divizionit të Burimeve Njerëzore në KEK.

Kontrata e punës për punëmarrësit që do të zgjedhën për plotësimin e pozitave të shpallura do të jetë 1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 3 muaj.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen

Prishtinë, 19.10.2018
Data e aplikimit deri më 02.11.2018



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

Prishtinë

Psikologji, sa fytyra është në gjendje të njohë truri ynë?

Sipas një hulumtimi anglez, një person mund të kujtojë deri në 5.000 fytyra mes njerëzve të njohur dhe personaliteteve të njohura (pa kujtuar domosdoshmërisht emrin)

Çdo qenie njerëzore mban më shumë ose më pak marrëdhënie të ngushta me një numër të njerëzve të tjerë që luhaten mesatarisht në mes 100 dhe 250, por, sa për shumë funksione të tjera, truri ka potencial shumë më të madh të magazinimit. Një hulumtim britanik ka treguar se normalisht çdo individ është në gjendje të njohë rreth 5000 fytyra, duke pasur parasysh si ata njerëz që njohim personalisht, po ashtu edhe të famshmit, të cilët pothuajse të gjithë i njohin. Rezultatet e këtij studimi, të kryera në 25 studentë të Universitetit të Glasgow, Skoci, u botuan në revistën B Proceeding të Shoqërisë Mbretërore.

Kapaciteti memorial

Për të identifikuar këtë aftësi të trurit për të njohur më shumë ose më pak 5.000 fytyra, Profesor Rob Jenkins i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin e Jorkut dhe bashkëpunëtorët e tij

në Universitetin e Aberdeens, Skoci, u është dashur të vënë në zbatim një strategji kërkimore, bazuar pjesërisht në një studim konkret, pjesërisht në një ekstrapolim të të dhënave. Si mund një individ në fakt të bëjë një ekzaminim të plotë të të gjitha fytyrave të njerëzve? Dhe gjithashtu duhet të kihet parasysh se në çdo rast njohja e një fytyre nuk do të thotë të jesh në gjendje të mban mend emrin e atij personi. Në këtë hulumtim, pra, qëllimi ishte vetëm për të vlerësuar se çfarë ishte "kapaciteti" mesatar i kujtesës për fytyrat e trurit njerëzor.

Studimi

Studimi është bërë veçmas për fytyrat e njerëzve të njohur drejtpërsëdrejti dhe për ata të njerëzve të famshëm. Për detyrën e parë, për secilin pjesëmarrës, studiuesit përgatitën një kartë mbështetëse shumë të detajuar me 14 kolona: anëtarët e familjes,



miqtë e familjes, miqtë e tyre, anëtarët e familjes së shokëve të tyre, shokët e klasës dhe mësuesit, fqinjët etj. Kolonat duhej të mbusheshin me shtresa, duke vazhduar me zhvillimin kohor të jetës. Një detyrë që ishte përfundimisht e pamundur për t'u kompletuar, dhe këtu mjeshtëria e kërkuesve: ata shpëtuan ecurinë e punës së çdo pjesëmarrësi çdo 5 minuta, duke vënë në dukje shkallën e avancimit dhe duke regjistruar gjithashtu se si, siç vazhdoi eksperimenti, numri i

fytyrave të kujtuara tentonte të ulte, duke ndjekur një model linear. Kështu, në fund të kohës së sondazhit, ata ndaluan pjesëmarrësit, jo për ta kthyer hulumtimin në torturë psikologjike. Në atë moment ata kryen një projektion mbi mënyrën se si puna do të vazhdonte të kujtonte fytyrat e njohura deri në momentin kur norma e kujtesës do të kishte rënë në zero. Një sistem pak a shumë i ngjashëm është përdorur për fytyrat e të famshmeve, edhe pse në këtë rast është përgatitur një

lloji i të dhënave vizuale të fytyrave për të lehtësuar punën e kujtesës dhe njohjes.

Aftësia për të njohur njerëzit është një evolucion

Pra, vendosja e forcave ka një racional nga pikëpamja neuroshkencore dhe antropologjike. Në fakt, siç shpjegojnë autorët e hulumtimit, "për shumicën e historisë njerëzore, grupet shoqërore kanë qenë të vogla dhe shumë të shpërndara. Një sistem që ka ndryshuar rrënjësisht në shekujt e fundit. Rritja e shpejtë e dendësisë së popullsisë çon në një ndryshim në kërkesën për aftësinë tonë për të identifikuar njerëzit që njohim – fytyra të njohura – nga ato të njerëzve që nuk i njohim – fytyra që nuk janë të njohura për ne. Hulumtimi konjektiv mbi perceptimin e fytyrave kishte zbuluar tashmë dallime të rëndësishme se si përpunohen fytyrat e njohura dhe të panjohura. Megjithatë, deri më sot askush nuk u përpoq të përcaktojë sa fytyra mund të njohë një person. Në disa mënyra, ne besojmë se ishte një lëshim disi shqetësues".

(gazeta-Shqip.com)

Metropolet, ja 5 qytetet më të mëdha në botë brenda 2030-ës

Xhakarta është në krye. Qytetet gjigante dhe rekorde të trishtuara në kriminalitet, përmbajtjeve dhe varfërisë

Xhakarta në krye që, në vitin 2030, do të arrijë rekord prej 35.6 milionë banorësh, duke hequr skeptrin nga Tokio që do të humbasë 2 milionë banorë për shkak të plakjes së përgjithshme të popullsisë.

Mega-qytetet më të populluara në vitin 2030 do të jenë Xhakarta, Tokio, Karaçi, Manila dhe Kajro. 5 kontinentet e para që do t'i presin ato do të jenë Kina, India, SHBA, Japonia dhe Brazili.

Ne po përballemi me një epokë të re në historinë e urbanizimit. Pesë qytete të reja mega (qytete me një popullsi që kalon 10 milionë banorë) do të mbizotërojnë në botë deri në vitin 2030. Në vitet '50, New York ka mbajtur skeptrin, por shpejt ia dha Tokios. Vitin e kaluar, 26 nga 33 megapololet ekzistuese në botë ishin në vendet në zhvillim

dhe në dymbëdhjetë vitet e ardhshme do të jenë pikërisht këto vende që do të dominojnë skenën e qyteteve të mëdha, me 5 metropole të reja të pafundme.

Midis megapoleve, sipas studimit, kinezët do të bëhen gjithnjë e më të shtrenjtë, pasi rritja e vazhdueshme ekonomike do të rrisë fitimet. Ndërkohë, Londra, ndër më të mëdhenjtë europiane së bashku me Parisin, Moskën dhe Stambollin, do të bëhen më të kapshëm, pasi Brexit rrezikon të ulë çmimet e pronës banesore. Raporti zbulon dallime të mëdha midis qyteteve mega që do të zhvillohen në vendet e Azisë dhe në vendet afrikane: disa qytete shumë të mëdha në Azinë Lindore janë viktime të një tendence të dukshme drejt plakjes, ndërsa Afrika përfaqëson zemrën e rritjes së popullsisë.



Me pak fjalë, njerëz të moshuar në Azi, të rinj në Afrikë.

Ruanda do të rrisë popullsinë me 60%, në Kajro do të ketë 6.3 milionë banorë dhe do të bëhet qyteti më i madh në Afrikë në 2030. Vetëm 7,3% e banorëve të Xhakartës do të jenë më shumë se 65 vjeç në 2030, kundër Seulit dhe Shangait, të cilat do të kenë përkatësisht një rritje prej mbi 65 vjeç, 9,2% dhe 7,1% mbi 65 vjeç, i pari dhe 2.2 milion mbi 65 vjeç, të dytin. Pekini ndjek me 1.8 milionënjerëz të moshuar. Në 2030-ën, qyteti më i vjetër më i madh do të jetë Osaka me 31% të

mbi 65-vjeçarëve.

Katër mega-qytete të tjera janë planifikuar në Bogota, Chennai dhe Bagdad. Së fundi Çikago, qyteti i vetëm që nuk del në mes të kësaj ruge të zhvillimit të mega-qyteteve.

Për këto qytete të reja që do të zgjerohen kufijtë e tyre, të pranishëm në vendet në zhvillim, por nuk korrespondojnë me një rritje ekuivalente ekonomike të rritjes ekuivalente. Fransua Vytautas Razvadauskas, analist i lartë Euromonitor International shpjegon: "15% e prodhimit të brendshëm bruto në botë vjen nga megalopole, duke pasur parasysh se 60% e popullsisë botërore do të bëhet urbane nga 2030.

Përkundër ndryshimeve në panoramën e megalopolit, tregjet kryesore të konsumit të së ardhmes do të vazhdojnë të jenë të vendosura në qytetet mega të zhvilluara,

duke garantuar të ardhura më të larta, kujdes shëndetësor dhe infrastrukturë. Të ardhurat totale në dispozicion të një megacity të zhvilluar do të jenë rreth pesë herë më të mëdha se një mega-qytet në zhvillim në vitin 2030, – thekson analisti.

Paralelisht me zhvillimin e qyteteve më të mëdha, analistët raportojnë një rritje të fenomeneve alarmuese, në veçanti rritjen e krimit, trafikun e mbingarkuar dhe ndotjen urbane. Zhvillimi i megalopoleve shënon, në fakt, gjithashtu të dhëna të reja të mjerueshme për varfërinë. Analistët përmendin qytetin e Makoko, Lagos në Nigeri, lagja më e madhe në botë me një popullsi prej 40,000 deri në 300,000. Rritja e tij është përjetësuar nga një migrim rurale në atë urbane dhe kalimi nga një fshat peshkimi në një lagje të varfër ka çuar në kushte të reja dhe të tmerrshme të jetesës.

(gazeta-Shqip.com)



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BOURNEMOUTH - SOUTHAMPTON

1

WOLVERHAMPTON - WATFORD

1

BLACKPOOL - AFC WIMBLEDON

1

Gjeraj: Liria kërkon pikë në Drenicë

Drenica dhe Lira përballen sot në stadiumin "Bajram Aliu" në kuadër të xhiros së njëmbëdhjetë në IPKO Superligë. "Ne duhet ta harrojmë sa ma shpejt që është e mundur humbjen nga Trepça '89 dhe që në ndeshjen me Drenicën të fillojmë të marrim rezultat pozitiv. Në Skenderaj shkojmë për të marrë rezultat të favorshëm. Dhe, kjo është e mundshme, pasi këtë edicion secila skuadër mund ta mposhtë skuadrën tjetër", ka thënë Robert Gjeraj

**EPOKA E RE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 19 TETOR - Mbrojtësi i KF Liria, Robert Gjeraj, ka thënë të premten për "Epokën e re" se skuadra nga Prizreni kërkon rezultat pozitiv në ndeshjen që zhvillohet sot (e shtunë) në Skenderaj ndaj Drenicës. Futbollisti me përvojë të madhe në skuadrën e Lirisë ka konfirmuar se mungesa nuk ka në klub dhe se synimi i tyre është t'u rikthehen rezultateve pozitive nga kjo ndeshje. "Ne duhet ta harrojmë sa ma shpejt që është e mundur humbjen nga Trepça '89 dhe që në ndeshjen me Drenicën të marrim rezultat pozitiv. Në Skenderaj shkojmë për të marrë rezultat të favorshëm. Dhe, kjo është e mundshme, pasi këtë edicion secila skuadër mund ta mposhtë skuadrën tjetër. Mungesa nuk kemi dhe jemi të përgatitur dhe të motivuar maksimalisht që ta

kthejmë vetëbesimin dhe të marrim rezultate sa më të mira në xhirot e ardhshme", ka thënë Gjeraj. Për ndeshjen ndaj Lirisë për gazetë ka folur edhe mesfushori i Drenicës, Taulant Dajaku. Ky i fundit ka shkuar edhe më larg, duke kërkuar maksimumin e pikëve në ndeshjen që zhvillohet në kuadër të xhiros së njëmbëdhjetë në IPKO Superligë. Mesfushori që është një nga lojtarët me përvojën më të madhe në skuadrën kuqezi ka kërkuar nga shikuesit ta mbushin stadiumin në mënyrë që marrja e tri pikëve të jetë më e lehtë. "Ndeshja e radhës do të jetë shumë e vështirë, pasi jemi të obliguar të fitojmë. Kjo do të ishte e vetmja formë për të treguar dhe vlerësuar pikët e marra ndaj Flamurtarit. Dua të besoj se stadiumi ynë do të jetë plot me tifozë në mënyrë që ekipi ta japë më të mirën dhe ta marrë fitoren e radhës", ka

thënë Dajaku. Drenica renditet e pesta me 15 pikë, kurse Liria është e dhjeta me katër pikë. Sot (e shtunë) zhvillohen edhe tri ndeshje të tjera derbi, kurse të dielën zhvillohen dy ndeshjet e fundit për këtë xhiro.

IPKO Superliga

Të shtunën takohen:
14:45 Ballkani - Flamurtari
14:45 Ferizaj - Drita
14:45 Drenica - Liria
15:00 Prishtina - KEK-u

Të dielën takohen:
14:45 Trepça '89 - Llapi
14:45 Gjilani - Feronikeli

LIGA E PARË

Fushë Kosova - Vushtrria
2 Korriku - Bashkimi (K)
Drenasi - Istogu
Dukagjini - Besa
Onix - Vitia
Vëllaznimi - Vllaznia
Arbëria - Kika
Ramiz Sadiku - Trepça

SHKURT

Kosova nuk mund të luajë ndaj Serbisë dhe Bosnjës

Edhe pse ka ende kohë deri në hedhjen e shortit për Kampionatin Evropian të Futbollit 2020, janë stiluar tashmë edhe ndeshjet me rrezik të lartë që duhet medoemos të evitohen. UEFA bëri me dije se cilat shtete nuk mund të jenë në të njëjtin grup eliminator për evenimentin kontinental dhe Kosova është në të paktën dy kryqëzime të pamundura. Qeveria e futbollit evropian ka vlerësuar se në një përballje mes përfaqësueses së trajnerit, Bernard Challandes dhe Serbisë, mund të ketë probleme serioze që kalojnë kufijtë e sportit. Për këtë arsye, është shmangur një mundësi e tillë. Gjithashtu, Kosova nuk do të luajë as kundër Bosnje-Hercegovinës, në një skenar të ndikuar nga zhvillimet politike dhe incidentet që UEFA shpreson se në këtë mënyrë, do të evitohen. Tre çifte të tjera që nuk do të mund t'i shohim në "Euro 2020", Armeni - Azerbajxhan për shkak të konfliktit të hershëm për rajonin e Nagorno Karabakut, Spanjë - Gjibraltari dhe Rusi - Ukrainë. Shorti për "Euro 2020" do të hidhet më 2 dhjetor, ndërsa për herë të parë në historinë prej 6 dekadash të UEFA-s do të zhvillohet në 10 shtete dhe 12 qytete. Finalja e madhe e Evropianit do të luhet në stadiumin "Wembley" të Londrës.

Sportistja Surdulli nderohet me Medalje të Meritave

Notarja Medina Surdulli është nderuar me Medaljen Presidenciale të Meritave pas suksesit të treguar në garën ndërkombëtare të notit për personat me Sindromën Dawn, duke zënë vendin e parë. Gëzimin për këtë nder nuk e ka fshehur protagonistja që korri suksese ndërkombëtare, Medina Surdulli, e cila, duke falënderuar presidentin, tha se ndihet tejet e lumtur. I pari i shtetit ka lexuar deklaratën me tonë ceremonial para Medina Surdullit dhe familjarëve të saj. "Medalja Presidenciale e Meritave i jepet Medina Surdullit për të arritura të larta në sportin e notit", ka thënë presidenti Hashim Thaçi. Kujtojmë se në këtë garë ndërkombëtare kanë marrë pjesë persona me Sindromën Down nga 11 vende: Britania e Madhe, Danimarka, Estonia, Turqia, Irlanda, Maqedonia, Romania, Shqipëria, Suedia dhe Kosova, e cila njëherësh ishte edhe organizatore e kësaj ngjarje sportive.

KB Rahoveci trimërohet pas katër fitoreve, falënderon mbështetësit

KB Rahoveci, pas një starti të shkëlqyer në nisje të këtij kampionati, ku arritën nga katër ndeshje, katër fitore, këto i ka vlerësuar si momente historike për qytetin. Ky klub nëpërmjet një njoftimi për medie ka falënderuar për përkrahje bizneset dhe individët që janë pranë klubit. "Bordi i KB Rahoveci dëshiron t'i falënderojë edhe një herë të gjithë mbështetësit duke u nisur nga kryetari i komunës, Smajl Latifi, i cili është në kontakt dhe angazhim të vazhdueshëm për gjendjen dhe ecurinë e klubit, kompanitë, 'EuroIng', 'AgroVinifera', 'Vala, KAG', 'Haxhijaha', 'Haxhijaha Trade', 'Bodrumi i Vjetër', 'M Sillosi', 'Osa Termosistem', 'Hotel Plaza', 'Artvision' të cilët i qëndruan afër klubit në çastet vendimtare dhe, mbi të gjitha, tifo grupin 'Vreshtarët' dhe gjithë të tjerët që janë çdo hap me ne", thuhet në njoftimin e KB Rahovecit. Skuadra e Rahovecit është në pritje të përfundimit të palestrës sportive, kurse ky klub ka ftuar të gjithë ata që janë të interesuar t'i bashkëngjiten në projektin që ka për qëllim ta fusë Rahovecin në analet e basketbollit ndërkombëtar.

Bekim Shotani, pasardhës i Bylbyl Sokolit tek Llapi

Prishtinë, 19 tetor - Bekim Shotani është trajner i ri i skuadrës së Llapit. Njoftimi për marrëveshjen me trajnerin Shotani e ka bërë faqja zyrtare e skuadrës nga Podujeva. "Pas marrëveshjes në mes të

drejtuesve dhe trajnerit Bekim Shotani do ta udhëheqë skuadrën në vazhden e kampionatit. Ai do të ndihmohet nga stafi përcjellës me ndihmësit Fadil Ademi, Driton Rrahmani, Ardian Sallahu e Bekim Mulliqi,

ndërsa sot Shotani iu bashkua futbollistëve në stërvitjen e parë të cilët i dëshiruan mirëseardhje dhe suksese të përbashkëta në vazhdim", thuhet në njoftimin e KF Llapit. Skuadra e Llapit në këtë edicion është drejtuar nga

Bylbyl Sokoli, i cili, pas shumë mosmarrëveshjeve me drejtuesit e klubit, është shkarkuar. Ndërsa Bekim Shotani e ka drejtuar skuadrën e Ballkanit por, pas disa rezultateve jo të mira, ka dhënë dorëheqje.



Gerrardi: Grezda është gati

GLASGOU, 19 TETOR - Eros Grezda është bashkuar menjëherë me skuadrën e vet pas dy ndeshjeve të Kombëtares së Shqipërisë. Tek Rangersi duket se e ka pritur mjaft mirë trajneri Stiven Gerrard, i cili

është mjaft i lumtur që do ta ketë të gatshëm lojtarin kuqezi për ndeshjen e radhës, diçka që e ka përmendur edhe në konferencën për shtyp. "Grezda është në gjendje të mirë dhe gati për ndeshjen e

kësaj jave", ka thënë trajneri anglez.

Duket se ka ardhur mundësia që ta shohim sulmuesin anësor nga minuta e parë, pasi deri më tani nuk ka mundur që të gjejë hapësira. Aktivizimi

me Kombëtaren ka qenë në të mirë të lojtarit që tani gradualisht po arrin formën optimale. Kjo gjë pa diskutim i ka pëlqyer edhe teknikut të gjigantëve skocezë, i cili ka një "armë" më shumë në arsenalin e tij.



Kabashi: Ballkani nuk dorëzohet asnjëherë

SUHAREKË, 19 TETOR - Presidenti i skuadrës së Ballkanit, Arsim Kabashi, ka thënë se skuadra nga Suhareka nuk është dorëzuar, por synon t'u rikthehet rezultateve pozitive. Sipas tij, askush në klub nuk është dorëzuar, përfshirë edhe donatorët, të cilët janë të bindur se Ballkani do të jetë ndër ekipet më të respektuara në Kosovë, pasi ka traditë 70-vjeçare. "Të gjithë jemi dëshmitarë që rezultatet e arritura në fushën e blertë nuk janë ato të cilat ne kemi kërkuar nga fillimi i këtij kampionati në Superligë dhe këtu kanë ndikuar shumë faktorë, pa dashur të veçojmë ndonjë. Unë si sponsor apo president i klubit, por edhe kryesia dhe sponsorët e tjerë nuk jemi dorëzuar asnjëherë dhe nuk do të dorëzohemi asnjëherë derisa ta rendisim Ballkanin ndër ekipet më të respektuara dhe më të mira në Kosovë. Ballkani ka një traditë mbi 70-vjeçare dhe e meriton të jetë ndër ekipet më të mira në vend", ka thënë Kabashi. "Ne do ta analizojmë situatën e krijuar në klub dhe do të vazhdojmë të punojmë me shumë vullnet dhe dashuri për FC Ballkanin, sepse duam ta bëjmë skuadrën që të gjithë e duan, t'i gëzojmë të gjithë



me suksese dhe ta bëjmë krenar qytetin. Prandaj kërkojmë mirëkuptimin tuaj, mbështetjen tuaj, pasi së bashku është më lehtë dhe së bashku jemi të

bindur se do t'u kthehemi rezultateve pozitive që nga ndeshja e fundjavës dhe të vazhdojmë me ndeshjet e radhës", ka deklaruar Kabashi.

Jamesi debuton me humbje te Lakersat

LOS ANGELES, 19 TETOR - Nuk ka nisur mirë aventura e LeBron Jamesit te skuadra e Lakersit, që u mund 128-119 nga Portlandi, në ndeshjen e parë që dy ekipet zhvilluan në NBA. "King James" realizoi 26 pikë, më i miri në fushë për kalifornianët, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Për Portlandin u dallua Lillardit me 28 pikë, mbështetur edhe nga Stauskasi me 24, duke bërë diferencën në fushë. Fitore në sekondat e fundit korri Miami, që mundi 113-112 Washingtonin jashtë fushës, takim me rivalitet dhe emociione, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. I zakonshmi Wall realizoi 26 pikë për Washingtonin, por që mbetën për statistikë, ndërsa për Miamin u dallua Richardson me 28 pikë. Fitoren e parë sezonale e arriti edhe Philadelphia, që mundi 127-108 Chicagon,



ndeshje e dominuar nga vendësit, që patën epërsi gjatë gjithë kohës. Embiid me 30 pikë ishte lider në fushë për Philadelphian, ndërsa për Bulls-in nuk mjaftuan 30 pikët e LaVine për të dalë fitues nga kjo sfidë.

REZULTATET

Philadelphia - Chicago 127-108
Washington - Miami 112-113
Portland - Lakers 128-119

SHKURT

Fillon shitja e biletave për ndeshjen Shqipëri - Skoci

Federata Shqiptare e Futbollit njofton të gjithë tifozët në faqen e vet zyrtare se ka filluar shitja e biletave online për të gjitha kategoritë për ndeshjen e UEFA Nations League, Shqipëri - Skoci, e cila do të luhet më 17 nëntor 2018, në orën 20:45, në stadiumin "Loro Boriçi". Çmimet e biletave sillen nga 500 lekë të tribunat C2, C3 dhe C4, që janë edhe më të lira, 750 në C1 dhe C5, 1000 në D1 dhe D4, 1500 në D2 dhe D3, 4000 në A dhe B e deri në 6000 lekë në tribunën VIP.

Ja çfarë po ndodh me Bajram Jashanicën

Bajram Jashanica u bë disa muaj që i mungon Skënderbeut dhe tifozëve. Dënimi dyvjeçar nga Komisioni i Dopingut në UEFA e ka detyruar të qëndrojë jashtë fushave të blerta. Gjithkush mund të ketë menduar se mbrojtësi po shijon pushimet, por e kundërta ndodh. Ai po vazhdon të stërvitet intensivisht, njësoj si pjesa tjetër e ekipit, me shpresën që vijnë lajme të mira nga KAS pas apelimit që i është bërë vendimit. Deri atëherë, kosovari do të vijojë t'i zhvillojë seancat stërvitore në Korçë por, për fatin e keq të Orges Shehit, nuk mund të llogarisë në asnjë ndeshje zyrtare, edhe pse forma e tij do të ishte një "armë" më shumë në mbrojtjen e kampionëve në fuqi të vendit.

Hazardi: Mund ta mbylli karrierën te Chelsea

Eden Hazard po kalon një formë të shkëlqyer tek ekipi i Chelseat. Belgu është një dëshirë e Real Madridit, ndërsa vetë lojtari është shprehur se ëndërron të luajë një ditë në "Santiago Bernabeu". Deklaratat e tij sollën kritika, ndërsa Hazardi ka bërë një hap mbrapa. Në prononcimin e fundit për "Sky Sports UK", 27-vjeçari, të cilit i skadon kontrata me Chelsean në vitin 2020, është shprehur se mund ta mbyllë karrierën në ekipin aktual. "Mund ta mbyll karrierën te Chelsea dhe nuk do të kishte asnjë problem për mua. Unë jam shumë i lumtur në këtë klub dhe familja ime është e lumtur në Londër. Kështu që, nëse nuk shkoj në Madrid, nuk është aspak problem. I adhuroj tifozët e Chelseat dhe mendoj se dhe ata më duan mua. Çfarëdo që të ndodhë në të ardhmen, do të jem i lumtur", ka thënë Hazardi.

Buffoni: Mbappe e meriton 'Topin e Artë'

Portieri Gianluigi Buffon ka shprehur mendimin se Kylian Mbappe e meriton "Topin e Artë". "Duke parë kualitetin e tij në fushën e lojës dhe duke llogaritur se sa vendimtar ishte gjatë Botërorit të kësaj vere, nuk kam dyshim se Kylian Mbappe meriton më shumë sesa të gjithë 'Topin e Artë'. Nuk mund të ketë vlerësim ndryshe për të. Ka një talent të jashtëzakonshëm dhe cilësi që nuk i kam parë te të tjerët. Është një fenomen dhe, nëse do të jetë ambicioz, do të ketë karrierë të gjatë", ka thënë Buffoni.

Lahmi mbron Neuerin

Ish-kapiteni i Bayern Munchen, Philipp Lahm, i ka dalë në mbrojtje portierit Manuel Neuer. Ai ka thënë se është e gabuar të diskutohen aftësitë e Manuel Neuerit. "Është e gabuar të diskutohet Manuel Neueri. Ka bërë pritje fantastike dhe, për mendimin tim, është i paprekshëm. Të bësh një-dy gabime pas caq muajsh dëmtim është normale. Kush sheh Manun në portë atëherë dallon hijen e tij, dallon që është një lojtar absolut dhe që ka gjithçka në fokus", ka thënë Lahmi.

Wengeri, mes Bayernit dhe Realit

Arsene Wenger dëshiron do t'i rikthehet futbollit duke marrë drejtimin e njërit prej dy gjigantëve të futbollit botëror, Bayern Munchen ose Real Madridit, raporton "Le Parisien". Ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, ka opsione të panumërta para vetes, me ekipin kombëtar të ShBA-së apo një rol të ngjashëm në Kinë që e presin, derisa Paris Saint-Germain e synon atë në rolin e drejtorit sportiv. Por, Wengeri dëshiron rolin e trajnerit në një klub të madh evropian, me Bayernin apo Realin si në listën e të preferuarve të tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë
Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Burimeve Njerëzore / Divizija za Ljudske Resurse / Human Resources Division

PËRSERITJE SHPALLJES SË REKRUTIMIT

Institucioni: Ministria e Shëndetësisë
Divizioni: Divizioni i Kujdesit Parësor Shëndetësor
Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Lartë për Monitorim dhe Implementim të Mjekësisë Familjare
Kategoria funksionale/Grada: Koeficienti - 8
Afati i kontratës: Nëpunës i karrierës – me kohë të pa caktuar
Nr. i Referencës: MSh-27/09/2018

Detyrat kryesore:

- Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
- Ndihmon në hartimin, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit, politikave, procedurave dhe dokumenteve lidhur me procesin e monitorimit dhe zbatimit të mjekësisë familjare, dhe jep rekomandime për avancimin e shërbimeve;
- Zhvillon dokumente dhe metoda praktike për monitorim dhe implementim të mjekësisë familjare dhe të njëjtat i promovon në të gjitha QMF nëpër Kosovë;
- Monitoron punën e Qendrave të mjekësisë Familjare, dhe për të njëjtat harton raport me shkrim, duke bashkangjitur rekomandimet për përmirësim të shërbimeve;
- Koordinon shkëmbimin e përvojave të Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe për të njëjtin qëllim organizon tryeza, simpoziume, konferenca, seminare etj;
- Bashkëpunon me institucione ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare në Kosovë për mundësinë e shkëmbimit të përvojave në nivelin rajonale e më gjerë;
- Mbështet eprorin në marrjen e vendimeve dhe palët e interesit në hartim të materialeve promovuese dhe koordinon fushatat me menaxhmentin e Qendrave të Mjekësisë familjare;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrës;

- Shkollimi i kërkuar:** Diplome universitare - Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme.

Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Së paku tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e mjekësisë familjare;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloret të aplikueshme lidhur me mjekësinë familjare;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi humluese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Data e hapjes dhe mbylljes së konkursit: 20.10.2018 deri 03.11.2018.

